

**FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS  
MJETET PENSIONALE**

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE**

*Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023*

<b>RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR</b> .....	1-4
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b> .....	5
<b>PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE</b> .....	6
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË MJETET NETO TË PJESËMARRËSVE</b> .....	7
<b>PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË</b> .....	8
<b>SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE</b> .....	9-37

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet pensionale (“FKPK-MP”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2023, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në mjetet neto të pjesëmarrësve dhe pasqyrën e rrjedhës së pasasë për vitin që përfundon në këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë politikat kontabël materiale dhe informacione të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të FKPK-MP me datën 31 dhjetor 2023, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e pasasë për vitin që përfundon në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’ në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga FKPK-MP në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi BSNEK), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

#### Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin më të rëndësishmet në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë mbi të, dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje. Secila çështje kryesore dhe adresimi ynë respektiv është përshkruar më poshtë.

Çështje kryesore e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
<p><b>Vlerësimi dhe ekzistenca e investimeve në fonde të hapura investuese</b></p> <p>Më 31 dhjetor 2023, FKPK-MP mbajti investime të klasifikuara me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes në shumën prej 2,013,518,138 EUR (31 dhjetor 2022: 1,689,250,011 EUR ) që përfaqësojnë 74% të gjithsej pasurive (31 dhjetor 2022: 70%).</p> <p>Shpalosjet e mëtejshme të investimeve janë përfshirë në shënimet 3.1, 3.9, 6 dhe 13 të pasqyrave financiare.</p> <p>Kjo ishte një fushë e fokusit dhe një fushë ku u drejtuan përpjekje të konsiderueshme të auditimit.</p>	<p>Në lidhje me çështjen e vendosur në anën e kundërt, përgjigjja jonë e auditimit përfshinë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ne kemi marrë pasqyrat mujore nga menaxherët dhe mbikëqyrësit e aseteve dhe kemi rakorduar me të dhënat e kontabilitetit dhe gjendjeve të llogarive të raportuara në pasqyrat financiare.</li> <li>• Ne kemi konfirmuar gjendjet e fundvitit me menaxherët dhe mbikëqyrësit e aseteve.</li> <li>• Ne pajtuam çmimet për të gjitha fondet e hapura investuese më 31 dhjetor 2023 me çmimet e kuotuar publikisht në tregjet aktive.</li> <li>• Ne kemi kontrolluar përshtatshmërinë e shpalosjeve të FKPK-MP në lidhje me investimet në fonde të hapura investuese.</li> </ul>
Çështje kryesore e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
<p><b>Mjetet neto të pjesëmarrësve</b></p> <p>Më 31 dhjetor 2023, mjetet neto të pjesëmarrësve arrijnë në 2,720,241,778 EUR (31 Dhjetor 2022; 2,426,644,184 EUR).</p> <p>Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2023 kontributet e njohura arrijnë në 288,915,435 EUR (2022: 244,518,592EUR) dhe riblerjet e njësisve për shkak të tërheqjes së kursimeve arrijnë në 71,606,416 EUR (2022: 54,871,291 EUR).</p> <p>Për më shumë, siç është shpalosur në Shënimin 1 dhe 14, mjetet e pensioneve janë ndarë në dy portfolio të ndara gjatë 2022-tës, dhe kriteret e përshtatshmërisë u rishikuan në vitin 2023. Kjo çoi në transfer në mes të portfoliove për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2023 në vlerë prej EUR 94,534,193(2022: 133,658,893EUR).</p> <p>Për shkak të materialitetit dhe kompleksitetit të transaksioneve të mësipërme, ne kemi konsideruar kontributet, riblerjet e njësisve dhe transferet ndër portfoliot si një çështje kryesore të auditimit.</p> <p>Shpalosjet e mëtejshme të mjeteve neto të pjesëmarrësve janë përfshirë në shënimet 5, 13 dhe 14 të pasqyrave financiare.</p>	<p>Auditim i mjeteve neto të pjesëmarrësve në tërësi ishte një kombinim i auditimit të kontrolleve dhe procedurave thelbësore të auditimit Ne kemi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Testuar modelin, zbatimin dhe efektivitetin e kontrolleve kryesore në lidhje me procesin e alokimit të kontributeve dhe tërheqjen e kursimeve.</li> <li>• Mbi bazë të mostrës ne kemi kontrolluar pagesën e marrë të kontributeve dhe kemi rakorduar deklaratat e llogarisë së punonjësve dhe punëdhënësve.</li> <li>• Mbi bazë të mostrës, ne kemi verifikuar nëse tërheqjet e kursimeve janë në përputhje me legjislacionin për Fondet Pensionale.</li> <li>• Mbi bazë të mostrës, ne kemi testuar nëse transferet ndër portfoliot janë bërë sipas kriterëve të pranueshmërisë të aprovuara.</li> <li>• Ne vlerësuam përshtatshmërinë e shpalosjeve të lidhura me FKPK-MP duke iu referuar politikës përkatëse të kontabilitetit.</li> </ul>

### **Informatat tjera**

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit. Raporti vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit. Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk mbulon informatat tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion sigurie mbi të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera të identifikuar më lartë kur të bëhet i disponueshëm, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar. Kur lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ka një keqdeklarim material në të, neve na kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe të raportojmë çështjen.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e FKPK-MP për të vazhduar aktivitetin në vijimësi, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë FKPK-MP ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të FKPK-MP.

### **Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport auditori që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një anomali materiale kur ekziston. Anomali mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, interpretime të deformuara ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Kuptojmë kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin në mënyrë që të hartohen procedura auditimi që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të FKPK-MP.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga menaxhmenti të bazës së vijimësisë të kontabilitetit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e FKPK-O për të vazhduar si vijimësi. Nëse arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri materiale, neve na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditorit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të bëjnë që FKPK-O të pushojë së funksionuar si vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

### **Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (Vazhdim)**

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje, ndër të tjera, me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë

Ne gjithashtu iu deklarojmë personave të ngarkuar me qeverisjen se ne jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike përkatëse lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera arsyeshëm mund të mendohet se cenojnë pavarësinë tonë, dhe aty ku është e aplikueshme, marrim masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuara personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin kryesore në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale prandaj janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditorit përveç rasteve kur ligji ose rregulloret përjashton shpalosjen në publik në lidhje me çështjen ose kur, në rrethana jashtëzakonisht të rralla, ne përcaktojmë se një çështje nuk duhet të komunikohet në raportin tonë, sepse pasojat e pafavorshme të veprimit të kësaj do të priten në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet e interesit publik nga një komunikim i tillë.

### **Raport për Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore**

Ne u zgjodhëm nga një proces i tenderimit të hapur dhe u emëruam si auditorë të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Ky është viti ynë i katërt si auditorë të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Ne konfirmojmë se opinioni ynë i auditimit për pasqyrat financiare i shprehur këtu është në përputhje me raportin shtesë për personat e ngarkuar me qeverisjen të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

*RSM Kosovo Sh.p.k.*

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtina, Republika e Kosovës

12 Prill 2024




Sadik Berisha

Auditor Ligjor

	Shënime	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
		EUR	EUR
<b>Mjetet</b>			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	4	152,330,062	32,130,471
Kontributet dhe të arkëtueshmet tjera	5	19,577,370	16,826,228
Mjetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes (VDFH)	6	2,013,518,138	1,689,250,011
Fletobligacionet e Kosovës	7	446,355,984	552,784,777
Afatizimet bankare	7	89,740,686	136,528,917
<b>Gjithsej mjetet</b>		<b>2,721,522,240</b>	<b>2,427,520,404</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrimet ndaj FKPKOP	8	581,097	564,679
Detyrimet tjera	9	699,365	311,541
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>1,280,462</b>	<b>876,220</b>
<b>Mjetet neto të pjesëmarrësve</b>		<b>2,720,241,778</b>	<b>2,426,644,184</b>

Autorizuar për publikim nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së dhe nënshkruar në emër të tyre më 28 mars 2024.

  
Z. Emanuel Bajra  
Kryesues i Bordit Drejtues

  
Z. Adrian Zalli  
Drejtor Menaxhues

  
Z. Vërshim Hatipi  
Drejtor për Financa dhe TI

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022
		EUR	EUR
<b>Të hyrat</b>			
Neto fitimet/(humbjet) nga mjetet financiare me VDFH	6	61,043,051	(138,775,369)
Neto të hyrat nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e normës efektive të interesit	4,7	16,479,824	14,154,892
Të hyrat nga dividendat	6	8,140,670	5,739,074
Të hyrat e tjera	10	2,000,000	-
<b>Gjithsej të hyrat / (humbjet)</b>		<b>87,663,545</b>	<b>(118,881,403)</b>
<b>Shpenzimet operacionale</b>			
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	11	(9,421,417)	(8,849,446)
<b>Gjithsej shpenzimet operacionale</b>		<b>(9,421,417)</b>	<b>(8,849,446)</b>
Neto lirimi / (ngarkesa) e humbjeve të pritura kreditore	7	230,845	(1,085,265)
<b>Rritja / (Rënia) në mjetet neto të pjesëmarrësve</b>		<b>78,472,973</b>	<b>(128,816,114)</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



	Kontributet e Pjesëmarrësve	Fitimet e Mbajtura	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
<b>Më 1 janar 2022</b>	<b>1,768,201,944</b>	<b>598,470,415</b>	<b>2,366,672,359</b>
Kontributet	244,518,592	-	244,518,592
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(40,751,339)	(14,119,952)	(54,871,291)
Riblerjet si pasojë e refundimeve	(862,652)	3,290	(859,362)
Rënia në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	(128,816,114)	(128,816,114)
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>1,971,106,545</b>	<b>455,537,639</b>	<b>2,426,644,184</b>
Kontributet	288,915,435	-	288,915,435
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(54,221,437)	(17,384,979)	(71,606,416)
Riblerjet si pasojë e refundimeve	(2,175,945)	(8,453)	(2,184,398)
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	78,472,973	78,472,973
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>2,203,624,598</b>	<b>516,617,180</b>	<b>2,720,241,778</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022
		EUR	EUR
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operacionale</b>			
Rritja / (Rënia) në mjetet neto të pjesëmarrësve		78,472,973	(128,816,114)
<i>Korrigjimet për:</i>			
(Fitimet) / Humbjet nga mjetet financiare me VDFH (neto nga tarifat e ndalura)		(58,387,849)	141,386,247
Neto lirimi / (ngarkesa) e humbjeve të pritura kreditore	7	(230,845)	1,085,265
Të hyrat nga interesi	4,7	(16,479,824)	(14,287,350)
Shpenzimet e interesit	4	-	132,458
		<b>3,374,455</b>	<b>(499,494)</b>
<i>Korrigjimet për lëvizjet neto në mjetet dhe detyrimet operacionale:</i>			
Rritja në mjetet financiare me VDFH, neto	6	(265,880,278)	(22,326,467)
Zvogëlimi / (rritja) në fletobligacionet e Kosovës	7	105,900,129	(62,072,081)
Zvogëlimi / (rritja) në afatizimet bankare	7	47,441,002	(91,527,091)
Rritja e detyrimeve ndaj FKPKOP	8	16,418	110,868
Rritja e detyrimeve për jo-kontribute	9	15,869	15,833
Rritja në të arkëtueshmet tjera	5	(17,053)	-
<b>Rrjedhja e parasë e përdorur në operacione</b>		<b>(109,149,458)</b>	<b>(176,298,432)</b>
Interesi i pranuar		16,586,563	13,494,812
Interesi i paguar		-	(146,601)
<b>Rrjedhja neto e parasë e përdorur në aktivitetet operacionale</b>		<b>(92,562,895)</b>	<b>(162,950,221)</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese</b>			
Kontributet e pranuar të pjesëmarrësve		286,181,346	241,462,429
Tërheqjet e kursimeve		(71,231,847)	(54,838,031)
Refondimet		(2,187,013)	(856,747)
<b>Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>		<b>212,762,486</b>	<b>185,767,651</b>
<b>Rritja neto në paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj</b>			
		<b>120,199,591</b>	<b>22,817,430</b>
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		32,130,471	9,313,041
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	4	<b>152,330,062</b>	<b>32,130,471</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1 TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (më tutje "FKPK"), regjistruar në adresën: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 90000225; është krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, më vonë e shfuqizuar nga Rregullorja 2005/20, kjo më vonë e shfuqizuar nga Ligji Nr. 03/L-084 i Republikës së Kosovës, edhe kjo më vonë e shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, dhe kjo e fundit e komplementuar me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-168, Nr. 05/L-116 dhe Nr. 07/L-016; si institucion financiar jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të aseteve pensionale, si dhe duke paguar shumat e akumuluar në llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursime pensionale, si menaxhues i mirëbuesar që vepron në të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.

Ligji Nr. 04/L-101 ka krijuar një program të kursimeve pensionale, të financuar nga kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe të administruara e të investuara përmes FKPK-së. Sipas këtij sistemi të kontributeve të definuara nga të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe punëdhënësit e tyre kërkohet të paguajnë kontribute pensionale (me përjashtim të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë). Secili pjesëmarrës ka llogari individuale në FKPK në të cilën kreditohen kontributet si dhe kthimi nga investimet.

FKPK-ja mbikëqyret nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga anëtarët ekspertë të investimeve dhe pensione, si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve dhe punonjësve të Kosovës. Sipas Ligjit Nr. 04/L-101, një anëtar pa të drejtë vote do t'i përfaqësojë interesat e Qeverisë. Gjatë vitit 2023 dhe 2022, Bordi Drejtues ka vepruar pa anëtarin pa të drejtë vote i cili e përfaqëson Qeverinë. Nga marsi 2023 FKPK-ja ka vepruar pa asnjë anëtar të Bordit Drejtues meqë mandatet e tyre kishin skaduar. Pesë anëtarë të Bordit Drejtues u emëruan nga Kuvendi i Kosovës në korrik 2023, mjaftueshëm për të pasur kuorum, por dy pozita ngelën bosh për pjesën e mbetur të vitit 2023 si dhe deri në datën e lëshimit të këtij raporti.

Këto pasqyra financiare janë për FKPK Mjetet Pensionale (ose "FKPKMP") e që janë kursimet pensionale (mjetet pensionale) të kontribuuesve. Pasqyrat financiare për FKPK Operacionet (ose "FKPKOP"), i cili është subjekti i menaxhimit dhe administrimit të kursimeve pensionale (mjeteve pensionale) të kontribuuesve, janë përgatitur veçmas për pasqyrat financiare për mjetet pensionale.

Që nga themelimi në vitin 2002 e deri më 2021, mjetet e FKPKMP janë investuar vetëm në Portfolion Standard, strategji e vetme investuese përshtatur për të gjithë pjesëmarrësit. Kjo ndryshoi më 16 shkurt 2022, me krijimin e Portfolios Konservative shtesë për pjesëmarrësit 63.5 vjeç e sipër. Nga 1 janari 2023 vendimi u ndërrua ashtu që Portfolio Konservative t'i përfshijë pjesëmarrësit 63.0 vjeç e sipër.

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

### 2.1 Deklarata e përputhjes

Pasqyrat financiare të FKPKMP janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet mbi to të përvetësuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

### 2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas konventës së kostos historike, përveç mjeteve financiare të bartura me VDFH të cilat maten me vlerë të drejtë. Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike kontabël. Po ashtu kërkohet që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të FKPK-së. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë domethënëse për pasqyrat financiare janë shpalosur në Shënimin 3.8 Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur më datë, dhe për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2023 dhe 2022. Shënimet aktuale dhe ato krahasuese janë të shprehura në euro, përveç ku është theksuar ndryshe. Sipas nevojës, të dhënat krahasuese janë riklasifikuar me qëllim të përshtatjes me prezantimin e vitit aktual.

#### Prezantimi i pasqyrave financiare dhe shënimeve

Për qëllime të qartësisë, pasqyrat financiare dhe shënimet e pasqyrave financiare janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe rëndësisë.

Kjo do të thotë që zërat e linjës që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të lidhura me përdoruesit e pasqyrave financiare, grumbullohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare primare.

Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime.

#### Vijimësia

Menaxhmenti i FKPK-së ka bërë një vlerësim të aftësisë së FKPK-së për të vijuar dhe është i opinionit që ka burime për të vazhduar aktivitetet në të ardhmen. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të ngrejë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë për të vijuar. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e vijimësisë.

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

#### i) Aplikimi fillestar i standardit të ri si dhe i ndryshimeve në standardet ekzistuese në fuqi për periudhën aktuale të raportimit

Ndryshimet në vijim në standardet ekzistuese, të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, ishin në fuqi për periudhën aktuale:

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimeve"** - në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023;
- **Shpalosja e Politikave Kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNRF Deklarata e Praktikës 2)** - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023. Menaxhmenti i ka rishikuar politikat kontabël dhe ka përditësuar informacionin e shpalosur në Shënimin 3 Politikat materiale kontabël (2022: Politika të rëndësishme kontabël) në raste të caktuara në përputhje me ndryshimet.
- **Tatimi i shtyrë që i përket asetëve dhe detyrimeve të cilat burojnë nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12)** - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023.
- **Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8)** - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023.
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet në të ardhura" - Reforma Ndërkombëtare e Tatimeve - Rregullat Model Shtylla e Dytë** - në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023.

Implementimi i të mësipërmeve nuk ka pasur ndikim material në pasqyrat financiare të FKPKMP.

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

#### ii) Standardet e reja si dhe ndryshimet në standardet ekzistuese të publikuara që ende nuk janë përvetësuar

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja dhe ndryshimet në standardet ekzistuese në vijim, janë publikuar por ende nuk ishin obligative për periudhën raportuese vjetore 31 dhjetor 2023:

- **Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhë ose jo-rrjedhë (Ndryshimet në SNK 1)** – në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024.
- **Detyrimet e qirasë në shitje ose në kthim (Ndryshimet në SNRF 16)** – në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024.
- **Dhënia e informacioneve shpjeguese për marrëveshjet financiare të furnitorëve (Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)** – në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024.
- **Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)** – në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2025 (e pa miratuar ende nga Bashkimi Evropian).
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve në mes të një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (data efektive është shtyrë për kohë të pacaktuar deri një projekt kërkimor në metoda të kapitalit neto është përfunduar).

FKPKMP ka zgjedhur të mos përvetësojë këto standarde, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime përpara se ato të hyjnë në fuqi. FKPMP parashikon që përvetësimi i këtyre standardeve dhe i ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të FKPMP në periudhën e zbatimit fillestar.

## 3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL

FKPKMP në mënyrë konsistente ka zbatuar politikat kontabël në vijim ndaj të gjitha periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç nëse thuhet ndryshe.

Po ashtu, FKPMP miratoi Shpalosjen e Politikave Kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNRF Deklarata e Praktikës 2) nga 1 janari 2023. Ndryshimet kërkojnë shpalosjen e politikave kontabël 'materiale' dhe jo të 'rëndësishme'. Megjithatë ndryshimet nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në vetë politikat kontabël, në raste të caktuara ato ndikuan në informacionin e politikave kontabël në lidhje me instrumentet financiare të shpalosura në shënimin 3.

### 3.1 Instrumentet financiare

Asetet dhe detyrimet financiare të bartura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë investimet, paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj, afatizimet bankare, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet.

#### Njohja fillestare dhe matja

Asetet dhe detyrimet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të FKPMP kur e njëjta bëhet palë e dispozitive kontraktuale të instrumentit ose në datën në të cilën ato burojnë.

Asetet financiare dhe detyrimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare (përveç aseteve financiare dhe detyrimeve financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten nga vlera e drejtë e aseteve ose detyrimeve financiare sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aseteve financiare ose detyrimeve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

Të gjitha shitblerjet në mënyrë të rregullt të aseteve financiare njihen dhe çregjistrohen në bazë të datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt janë blerje ose shitje të aseteve financiare që kërkojnë dorëzim të aseteve brenda kornizës kohore të përcaktuar me rregullore ose konventën e tregut.

#### Kompensimi

Asetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston e drejta e zbatueshme ligjrisht për kompensim të shumave të njohura dhe ka qëllim për shlyerje mbi bazën neto.

#### Klasifikimi dhe matja e aseteve financiare dhe detyrimeve financiare

Sipas SNRF 9, asetet klasifikohen në bazë të modelit të biznesit të adoptuar për administrimin e aseteve dhe në karakteristikat e tyre kontraktuale të fluksit monetar në një nga kategoritë e mëposhtme të matjes:

- Kosto e amortizuar (AMC);
- Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDAT); ose
- Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

### 3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.1 Instrumentet financiare (vazhdim)

Në njohjen fillestare, FKPKMP i klasifikon asetet financiare të matura me koston e amortizuar ose me Vlerën e Drejtë përmes Fitimit dhe Humbjes (VDFH).

Aseti financiar matet me AMC nëse përmbushen të dy këto kushte dhe nuk mbahet sipas VDFH:

- mbahet brenda një modeli biznesi për qëllimin e mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale në data të caktuara krijojnë flukse monetare që janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit (VPKI).

Të gjitha asetet e tjera të FKPKMP maten me VDFH.

FKPKMP ka përcaktuar se ka dy modele të biznesit:

- Modeli i biznesit 'Mbaj për të arkëtuar': ky përfshin parandë e gatshme dhe ekuivalentët e saj, investimet në fletobligacionet e Kosovës dhe depozitat bankare. Këto mjete financiare mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.
- Modeli tjetër i biznesit: këtu përfshihen investimet në fondet e hapura, të cilat përbëhen nga investimet në aksione, instrumente të borxhit, derivativët, etj. Këto asetet financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet mbi bazën e vlerës së drejtë. FKPKMP para se gjithash është e fokusuar në informacionin mbi vlerën e drejtë dhe e përdor atë informacion për të vlerësuar performancën e aseteve dhe për të marrë vendime. FKPKMP nuk ka shfrytëzuar opsionin për të caktuar në mënyrë të pakthyeshme ndonjë letra me vlerë të aksioneve përmes VDAT.

Në përgjithësi, detyrimet financiare maten me kosto të amortizuar.

#### Testi VPKI (vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit mbi shumën e mbetur të kryegjësë)

Hapi i dytë në klasifikimin e aseteve financiare në portofol që "mbahen për të arkëtuar" lidhet me vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me testin VPKI. Shuma e kryegjësë pasqyron vlerën e drejtë në njohjen fillestare minus çdo ndryshim të mëvonshëm, p.sh. për shkak të shlyerjes. Interesi duhet të përfaqësojë vetëm konsideratë për vlerën në kohë të parasë, riskun kreditor, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe një marzh fitimi në përputhje me tiparet bazë të huadhënies. Nëse flukset monetare sjellin më shumë se ekspozim të papërfillshëm ndaj rrezikut ose luhatshmërisë që nuk është në përputhje me tiparet bazë të huadhënies, asetit financiar njihet detyrimisht në VDFH.

Në përgjithësi, portofolet e aseteve financiare të FKPKMP që "mbahen për të arkëtuar" kanë flukse monetare kontraktuale që janë përgjithësisht në përputhje me testin VPKI.

#### Matjet pasuese

*Kosto e amortizuar:* Kosto e amortizuar e një aseti ose detyrimi financiar është shuma me të cilën matet aseti ose detyrimi financiar në njohjen fillestare minus shlyerjet e kryegjësë, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference midis shumës fillestare dhe asaj të maturimit, dhe për asetet financiare, korrigjuar për çfarëdo provizionimi. Të hyrat nga interesi nga këto asetet financiare llogariten duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

*Mjetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes:* Këto asetet më pas maten me vlerën e drejtë. Fitimet dhe humbjet neto nga ndryshimet në vlerën e drejtë, duke përfshirë çdo fitim dhe humbje nga këmbimi valutor, njihen si "Neto fitimet/(humbjet) nga mjetet financiare me VDFH", në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### Dëmtimet

FKPKMP mbi bazën e parashikimit vlerëson humbjet e pritshme kreditore (HPK) të lidhura me asetet e instrumenteve të borxhit të matura me kosto të amortizuar. FKPKMP në çdo datë raportimi nje një provizion humbjes për humbjet e tilla. Matja e HPK pasqyron:

- Një vlerë të paanshme me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme;
- Vlerën kohore të parasë; dhe
- Informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që janë në dispozicion pa kosto dhe përpjekje të tepërta në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

#### Ç'regjistrimi

Asetet financiare, ose një pjesë e tyre, çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare nga aseti kanë skaduar, ose kur ato janë transferuar dhe, ose (a) FKPKMP transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, ose (b) FKPKMP as nuk transferon dhe as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe FKPKMP nuk e ka mbajtur kontrollin.

Detyrimet financiare ç'regjistrohen kur aty shlyhen (pra, kur obligimi i theksuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose ka skaduar).

### 3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.2 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Për qëllime të rrjedhjes së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja në bankë dhe me brokerin, paraja në dorë dhe depozitat afatshkurtra me afat origjinal të maturimit deri në tre muaj. Përjashtim nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj bëjnë investimet në afatizime bankare pa datë maturimi por me afat paralajmërimi dhe të cilat Bordi Drejtues nuk ka për qëllim t'i tërheq.

#### 3.3 Kontributet

Kontributet e pranuar nga pjesëmarrësit llogariten në bazë të keshit, përpos për kontributet e muajit të fundit të periudhës, të cilat llogariten në bazë akruale dhe paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar si kontribute të arkëtueshme siç sqarohet tutje në Shënimin 5.

#### 3.4 Tërheqjet e kursimeve dhe refondimet

Tërheqjet e kursimeve (pagesat e benefiteve), si dhe refondimet e kontributeve të gabuara, njihen në periudhën në të cilën njësiti përkatës janë riblerë. Bilanci i (a) vlerës së njësive të riblera për shkak të tërheqjes së kursimeve; dhe (b) vlerës nominale të njësive të riblera shkak të refondimeve; të pagueshme në fund të periudhës, janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si detyrime për njësiti e riblera dhe janë detajuar më tej në Shënimin 9.

Tërheqja e kursimeve nga llogaria e pjesëmarrësit mund të bëhet në rastet e mëposhtme:

##### **Pjesëmarrësi arrin moshën e pensionimit prej 65 vjeç**

Një pjesëmarrës që pensionohet me bilanc të kursimeve nën ose të barabartë me pragun prej 3,000 EURO, i merr të gjitha kursimet me një pagesë të vetme. Në anën tjetër, nëse pjesëmarrësi pensionohet me bilanc mbi këtë prag, ai / ajo ka mundësinë të marrë 20% të bilancit menjëherë, ndërsa pjesa e mbetur duhet të merret në faza, përmes pagesave mujore të programit të tërheqjes në faza, derisa sa kursimet të shterrojnë. Pagesat mujore caktohen si 1% e bilancit të llogarisë me rastin e riblerjes së njësive nga FKPK, ose 200 EUR, cilado që është më e lartë.

Pjesa që merret në faza, transferohet nga FKPK në bankën komerciale të përzgjedhur nga pjesëmarrësi, dhe më pas banka i bën pagesat mujore te i pensionuari. Duke pasur parasysh që mjetet e pjesëmarrësve nuk janë më në kujdesin e FKPK-së, ato nuk bëjnë më pjesë në kontabilitetin e FKPKMP.

##### **Pjesëmarrësi është duke marrë pension invalidor**

Një pjesëmarrës që është dukë marrë pensioni invalidor, për një numër të caktuar vitesh, siç vendoset nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mund t'i tërheqë kursimet përmes programit të tërheqjes në faza. Tërheqjet janë të kufizuara në 2,400 EUR për secilin prej viteve që mbulon pensioni invalidor, ose në bilancin e plotë të kursimeve, cilado që është më e ulët. Njësoj si më sipër, këto mjete nuk llogariten më nga FKPKMP, meqë transferohen në bankën komerciale, e cila i bën pagesat mujore prej 200 EUR te pjesëmarrësi derisa fondet të shterrojnë.

##### **Pjesëmarrësi nuk është, dhe nuk ka qenë, i detyruar të kontribuojë në fondin pensional**

Një shtetas i huaj, i cili kurrë nuk ka pasur nënshtetësi të Kosovës, dhe të cilit kurrë nuk i është lëshuar, nga Ministria e Punëve të Brendshme, statusi i residentit të përhershëm në Kosovë të, mund t'i tërheqë të gjitha kursimet pensionale, me kusht që Administrata Tatimore të konfirmojë që pjesëmarrësi nuk është, dhe nuk ishte, i detyruar ndonjëherë kontribuojë.

##### **Pjesëmarrësi vdes para se të mbushë moshën e pensionimit**

Trashëgimtari legjitim zgjedh të marrë hisen e tij / saj, të kursimeve të pjesëmarrësit të vdekur, përmes (a) një pagese të vetme, ose (b) transferimit në llogarinë e tij / saj të kursimeve në FKPK. Prioriteti i trashëgimtarëve është si vijon: (1) bashkëshorti/ja, (2) fëmijët dhe (3) të tjerët, siç vendoset nga gjykata ose noteri.

Rregullat për tërheqjen e kursimeve, përfshirë pragjet, përcaktohen nga BQK-ja në Rregulloren e saj për tërheqjen e kursimeve pensionale. Rregullat e tërheqjes në faza janë të kushtëzuara derisa të fillojë ofrimi i aniteteve në Kosovë.

#### 3.5 Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve

Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve llogariten në baza ditore dhe njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Formula për kalkulimin ditor të tarifave është:

Tarifa = [Mjetet bruto të pjesëmarrësve] \* [Norma] / [Numri i ditëve kalendarike në vit].

Detajet e tarifave të ngarkuara janë paraqitur në Shënimin 11. Në anën tjetër, bilanci i (a) tarifave; dhe (b) diferencës midis vlerës së njësive të riblera për shkak të refundimeve (vlera e riblerjes) dhe shumës së refunduar tek pala (kontributi nominal); të pagueshme në fund të periudhës janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si detyrime ndaj FKPKOP, dhe detajohen më tej në Shënimin 8.

### 3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.6 Jo-kontributet

Transferet hyrëse në llogarinë e FKPKMP në BQK për mbledhje kontributesh, të cilat në momentin e procesimit të ekstraktit bankar identifikohen se nuk janë kontribute pensionale, klasifikohen si jo-kontribute dhe për to nuk emetohen njësi. Shembuj të transferove të tilla kryesisht përfshijnë mbipagesat e punëdhënësve ose pagesat e obligimeve të tjera (p.sh. tatime), si dhe kthimet e pagesave të benefiteve për shkak të detajeve bankare të pasakta ose llogarive bankare të mbyllura. Bilanci i jo-kontributeve të pagueshme në fund të periudhës paraqitet në shënimin 9 si detyrime për jo-kontribute.

#### 3.7 Tatimi

Mjetet pensionale të FKPK-së janë të liruara nga tatimi në fitim i korporatave.

#### 3.8 Vlerësimet dhe gjykimet e konsiderueshme

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të mjeteve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Menaxhmenti gjithashtu duhet të ushtrojë gjykim në zbatimin e politikave kontabël të FKPKMP. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme.

Ky shënim shpalosë fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit dhe kompleksitetit dhe burimet kryesore të sigurisë së vlerësimit që kanë një rrezik të theksueshëm për të rezultuar në përshtatje materiale gjatë vitit të ardhshëm financiar. Informata të hollësishme për secilën nga këto vlerësime dhe gjykime përfshihen në shënimet përkatëse së bashku me informacionin në lidhje me bazën e llogaritjes për çdo element të linjës së prekur në pasqyrat financiare.

#### Matja e provizionit për humbjet e pritshme kreditore

Matja e provizionit për HPK për asetet financiare të matura me koston e amortizuar është një sferë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozime të theksueshme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë. Shpjegimi i këtyre inputeve, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit të përdorura në matjen e HPK është detajuar më tej në Shënimin 3.9.5, i cili gjithashtu përcakton ndjeshmëritë kyçe të HPK ndaj ndryshimeve në këto elemente.

Disa gjykime të rëndësishme gjithashtu janë të nevojshme për zbatimin e kërkesave të kontabilitetit për matjen e ECL, si:

- Përcaktimi i kriterëve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë;
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e HPK;
- Vendosja e numrit të peshave relative të skenarëve parashikues për çdo lloj produkti / tregu dhe HPK-në përkatëse; dhe
- Krijimi i grupeve të aseteve të ngjashme financiare për qëllime të matjes së HPK.

#### 3.9 Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e FKPKMP e ekspozojnë atë ndaj një game të rreziqeve financiare: risku i tregut (përfshirë riskun valutor, riskun e normës së interesit të vlerës së drejtë dhe të rrjedhës të parasë, si dhe riskun e çmimit), riskun kreditor dhe të likuiditetit. Programi i përgjithshëm i menaxhimit të riskut të FKPKMP kërkon t'i maksimizojë kthimet për nivelin e riskut të cilit i është ekspozuar FKPKMP dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative në performancën financiare të FKPKMP.

Kur është në pyetje vlerësimi i riskut të instrumenteve financiare të cilat përbëjnë pjesën e aseteve të FKPKMP, pjesa dërrmuese e investimeve janë përmes instrumenteve për investime të hapura, që nënkupton se menaxhimi i riskut në baza ditore i është besuar menaxhuesve të këtyre instrumenteve. Humbja maksimale është e barabartë me vlerat kontabël të aseteve financiare. Menaxhimi i këtyre risqeve kryhet nga menaxherët e fondeve dhe nga menaxhmenti e Bordi i FKPK-së.

Politika e investimeve mbi të gjitha kërkon që mjetet e investuara, qoftë direkt a indirekt, të jenë të diversifikuara mirë nëpër emetues dhe klasa të aseteve, si dhe në qasje investuese të fondeve të hapura investuese. Si mënyrë për menaxhim të risqeve direkte, politika vendos kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në klasa instrumentesh të caktuara, siç është shpalosur në shënimin 13.d). Në përputhje me këtë kornizë Bordi Drejtues merr vendime të rrisë ose zvogëtojë ekspozimin ndaj një instrumenti të caktuar për investime të hapura varësisht nga performanca dhe plasmanet e instrumentit, ose korrelacionit të tij me instrumentet e tjera, si dhe bindjet për perspektivën afatshkurtër dhe afatmesme për klasën e aseteve dhe qasjen investuese të instrumentit në fjalë. FKPK-ja nuk aranzhon kontrata në avancë (*forwards*), shkëmbime (*swaps*) ose derivate të tjera (*derivatives*) për të menaxhuar dhe kontrolluar këto risqe për mjetet e FKPKMP.

Departamenti i Investimeve dhe Riskut i FKPK-së në baza të rregullta analizon pajtueshmërinë e investimeve, direkte si dhe indirekte përmes portofoliove të instrumenteve për investime të hapura, me politikat investuese të FKPK-së. Risku dhe luhatshmëria e investimeve direkte dhe indirekte po ashtu vlerësohen në baza të rregullta. Të gjeturat shqyrtohen nga Komisioni i investimeve i Bordit Drejtues të FKPK-së, dhe shërbejnë si ndihmë në vendimmarrje për investimet.

Në vijim prezantohen rreziqet kryesore të cilave direkt iu ekspozoheshin asetet e FKPKMP në datat e raportimit:



### 3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.9 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

##### 3.9.1 Risku i normës së interesit (Portfolio Standarde dhe Konservative)

Risku i normës së interesit është risku që vlera reale e rrjedhave të ardhshme të parasë nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregje. Në datën e raportimit FKPMP nuk kishte detyrime të ekspozuara ndaj riskut të normës së interesit, por kishte investime direkte në fletobligacione të Thesarit të Kosovës si dhe depozita me afat me bankat komerciale të cilat kishin normë fikse të interesit në shumën 536,096,670 EUR (2022: 689,313,694 EUR). Nuk kishte investime direkte në instrumente financiare me normë variabile të interesit.

##### 3.9.2 Risku i çmimit (Portfolio Standarde)

Mjetet janë të ekspozuara ndaj rrezikut të çmimit të instrumenteve. Kjo vjen nga investimet e mbajtura nga FKPMP për të cilat çmimet në të ardhmen janë të pasigurta. Aty ku instrumentet financiare jomonetare janë në monedha të ndryshme nga euro, çmimi fillimisht i dhënë në valutë të huaj e që më pas konvertohet në euro do të luhet edhe për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Shënimi 3.9.3 'Risku valutor' më poshtë përcakton se si menaxhohet dhe matet ky komponent i riskut të çmimit.

Përkundër uljes së moderuar të ndryshimisë ndaj ndryshimit të vlerës së drejtë të instrumenteve për investime të hapura, risku i çmimit vazhdon të jetë faktori më i rëndësishëm i riskut direkt ndaj asetëve të investuara të FKPMP. FKPMP përmes politikës së investimeve tenton të menaxhojë këtë risk duke i shpërndarë investimet në instrumente për investime të hapura pa korreleacion me njëra-tjetër, e që në portofolet e tyre investuese kanë klasa të ndryshme të instrumenteve financiare si dhe qasje dhe objektiva të ndryshme investuese.

##### Analiza e ndryshimisë ndaj ndryshimit të çmimit të fondeve të hapura për investime

Sikur çmimet e instrumenteve për investime të hapura të ishin 5% më të larta/ulëta në datën e raportimit, atëherë mjetet neto të pjesëmarrësve do të rriteshin/ulëshin me 100,675,907 EUR (2022: 84,462,501 EUR).

Rënia maksimale (*maximum drawdown*) për Portfolion Standarde të FKPMP për periudhën 1 vjeçare të përfunduar më 31 dhjetor 2023 ishte 4.2% ndërsa për periudhën 3 vjeçare ishte 7.6% (2022: 7.6% dhe 9.4% përkatësisht).

Raporti i luhatshmërisë kundrejt performancës për periudhën 1 vjeçare të përfunduar më 31 dhjetor 2023 ishte 0.66; ku luhatshmëria vjetore ishte 4.6% dhe performanca +3.0% (2022: -0.85, 6.5% dhe -5.5% përkatësisht). Nga ana tjetër raporti për periudhën 3 vjeçare ishte 0.49; ku luhatshmëria vjetore ishte 5.1% ndërsa performanca vjetore +2.5% (2022: 0.47, 5.3% dhe +2.5% përkatësisht).

##### 3.9.3 Risku valutor (Portfolio Standarde)

Rreziku valutor lind kur vlera e transaksioneve të ardhshme, asetëve monetare të njohura dhe detyrimeve monetare në valuta të tjera luhet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Në datën e raportimit plasmanet në fletobligacionet e Thesarit të Kosovës si dhe afatizimet në banka ishin të gjitha në valutën EUR.

Si mjet për menaxhimin e riskut valutor në instrumentet për investime të hapura, politika e investimeve e FKPK lejon vetëm deri në 20% të gjithëj mjetëve të FKPMP të jenë të investuara në instrumente jo të denominuara në EUR dhe pa mbrojtje në EUR. Nuk ka kufizim të tillë për plasmanet indirekte, gjegjësisht plasmanet e bëra nga vetë fondet e hapura për investime.

Nga 21 fondet në të cilat FKPK kishte investime në datën e raportimit: (a) 12 ishin të denominuara në EUR, me shumë totale prej 1,646,036,940 EUR që përfaqëson 60.5% të gjithëj mjetëve; (b) 9 ishin të denominuara në USD, me shumë totale prej 367,481,198 EUR, që përfaqëson 13.5% të gjithëj mjetëve (2022: 17 fonde në EUR me shumë 1,217,778,938 EUR ose 50.2% e gjithëj mjetëve, dhe 9 fonde në USD me shumë 471,471,073 EUR ose 19.4% e gjithëj mjetëve). Megjithatë fondet janë të denominuara në EUR ose USD, instrumentet përbërëse të tyre do të jenë në shumë valuta dhe në përqindje të ndryshme të alokimit. Disa menaxherë fondesh përdorin derivativë të valutave për të menaxhuar dhe kontrolluar riskun valutor. Mirëpo, meqë përbërja e fondeve nuk përcaktohet apo kontrollohet nga FKPK-ja, dhe mjetet nuk investohen në masë domethënëse nga FKPK drejtpërdrejt në puro instrumente të denominuara në USD, nuk kryhen analiza sensitiviteti në efektin e ndryshimeve të valutës në të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 dhjetor, 2022 dhe 2023.

### 3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.9 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

##### 3.9.4 Risku i likuiditetit (Portfolio Standarde dhe Konservative)

Risku i likuiditetit është risku që FKPMP do të hasë në vështirësi për t'i kryer obligimet që lidhen me detyrimet financiare të cilat shlyhen përmes parasë së gatshme ose asetëve tjera financiare. Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e parave të gatshme të mjaftueshme, disponueshmërinë e fondeve nëpërmjet instrumenteve adekuate kreditore dhe aftësinë për arkëtim në kohë - brenda afateve të përcaktuara - të shumave të arkëtueshme nga palët e treta.

Risku i likuiditetit menaxhohet duke vlerësuar riblerjet mujore si pasojë e tërheqjes së kursimeve dhe refundimeve, si dhe mbajtjen e keshit të mjaftueshëm për këtë qëllim. Risku i likuiditetit është i ulët marrë parasysh se mesatarja e riblerjeve mujore nga FKPMP për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 ishte 6,118,238 EUR, dukshëm më të ulëta sesa kontributet mesatare mujore të arkëtuara për vitin në shumën prej 23,848,445 EUR (2022: 4,641,232 EUR dhe 20,121,869 EUR).

Investimet e matura me vlerë të drejtë (instrumentet e hapura për investime) mund të tërhiqen brenda 1 deri 5 ditëve dhe janë paraqitur tek kategoria afatshkurtër. Investimet e FKPMP në instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës kanë një afat origjinal të maturimit deri në dhjetë vjet, ndërsaq afatizimet bankare kanë afat origjinal të maturimit prej 1 dhe 2 vjet.

Tabela e mëposhtme paraqet maturimet kontraktuale të mbetura të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FKPMP.

	Më 31 dhjetor 2023			Më 31 dhjetor 2022		
	Deri 1 vit	1-5 vjet	5-10 vjet	Deri 1 vit	1-5 vjet	5-10 vjet
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Mjetet financiare</b>						
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	152,330,062	-	-	32,130,471	-	-
Mjetet financiare me VDFH	2,013,518,138	-	-	1,689,250,011	-	-
Fletobligacionet e Kosovës	107,599,471	252,868,620	85,887,893	140,983,493	280,845,025	130,956,259
Afatizimet bankare	42,443,059	47,297,627	-	102,100,101	34,428,816	-
Kontributet dhe të arkëtueshmet tjera	19,577,370	-	-	16,826,228	-	-
	<b>2,335,468,100</b>	<b>300,166,247</b>	<b>85,887,893</b>	<b>1,981,290,304</b>	<b>315,273,841</b>	<b>130,956,259</b>
<b>Detyrimet financiare</b>						
Gjithsej detyrimet	<b>1,280,462</b>	-	-	<b>876,220</b>	-	-
<b>Hendeku i maturimit</b>	<b>2,334,187,638</b>	<b>300,166,247</b>	<b>85,887,893</b>	<b>1,980,414,084</b>	<b>315,273,841</b>	<b>130,956,259</b>

### 3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.9 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

##### 3.9.5 Risku kreditor (Portfolio Standarde dhe Konservative)

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të FKPKMP nëse një klient ose palë nuk kryen detyrimet e tij kontraktuale.

##### Analiza e riskut kreditor

Ekspozimi i FKPKMP ndaj riskut kreditor buron nga instrumentet në vijim:

- **Paraja në bankë** - Paraja në bankë përbëhet nga paratë në llogaritë rrjedhëse në BQK dhe me brokerin. Më 31 dhjetor 2023, 90% e gjithë parasë në bankë ishte në llogarinë me BQK. Nuk ka vlerësim kreditor për Republikën e Kosovës, por, për shkak të natyrës afatshkurtër, risku kreditor nuk konsiderohet i theksuar dhe nuk llogariten humbjet nga dëmtimi.
- **Fletobligacionet e Kosovës** - sipas ligjit, FKMP-MP mund t'i investojë deri në 30% të mjeteve në fletobligacionet qeveritare të emetuara Republika e Kosovës. nga Më 31 dhjetor 2023, ekspozimi i FKPKMP në letrat me vlerë të lëshuara nga Qeveria e Kosovës u zbrit në 16% (2022: 23%) Fletobligacionet e Kosovës nuk kanë vlerësim kreditor.
- **Afatizimet bankare** - përbëhen nga depozitat me afat të investuara me bankat komerciale në Republikën e Kosovës. Më 31 dhjetor 2023, ekspozimi më i lartë ndaj një bankë të vetme ishte 36% (2022: 29%).
- **Fondet e hapura për investime** - investimet e disa prej fondeve të hapura, me të cilat FKPKMP ka mjete të investuara, janë të ekspozuara ndaj riskut kreditor përmes plasmanëve në fletobligacione të korporatave apo thesareve, dhe përmes instrumenteve të tjera të borxhit. Meqë këto maten (a) me vlerë të drejtë; dhe (b) nuk është e mundur të sigurohet informacioni i mjaftueshëm që besueshëm të vlerësohet risku kreditor i secilit plasman të këtyre fondeve të hapura; për to nuk kalkulohet provizion për dëmtimet.

##### Humbjet e pritura kreditore (HPK)

Në çdo datë raportimi, FKPKMP mat provizionin e humbjeve në asetet financiare të matura me kosto të amortizuara me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë jetës së instrumentit, nëse risku kreditor është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Nëse, në datën e raportimit, risku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, FKPKMP mat provizionin e humbjeve me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore 12-mujore. Vështirësitë e rëndësishme financiare të palës tjetër, probabiliteti që pala tjetër të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar, dhe mospagesat konsiderohen të gjithë tregues që vlerat mund të jenë të dëmtuara.

Një rritje e konsiderueshme e riskut kreditor përcaktohet nga menaxhmenti si çdo pagesë kontraktuale e cila ka më shumë se 30 ditë vonesë. Çdo pagesë kontraktuale e cila ka më shumë se 90 ditë vonesë konsiderohet kredi e dëmtuar.

##### Matja e HPK-së

Në vlerësimin e HPK-së, FKPKMP përdor shkallët e mospagesës të publikuara të emetuesve të të njëjtit rejting. Kur rejtingu nuk është i disponueshëm, përdoren shkallët e mospagesës për emetues të ngjashëm. Matja përshtatet për (a) kohëzgjatjen kur një instrument i caktuar ka më pak se një vit deri në maturim; (b) shkallët e rikuperimit për emetues të ngjashëm; dhe (c) faktorët e skontimit për normat e instrumenteve përkatëse.

Duke pasur parasysh inputet e mësipërme, të gjitha fletobligacionet e Kosovës dhe depozitat me afat janë klasifikuar si Fazë 1, me modelin e dëmtimit 12-mujor, dhe nuk pati lëvizje nëpër faza gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2023.

### 3 POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.9 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

##### 3.9.6. Matja e vlerës së drejtë

Mjetet dhe detyrimet financiare grupohen në tre nivele hierarkike të vlerës së drejtë të cilat bazohen në rëndësinë e shënimeve hyrëse gjatë matjes së vlerës së drejtë të mjeteve financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (jo të përshtatura) në tregjet aktive për asete dhe detyrime identike;  
 Niveli 2: shënimet e tjera hyrëse, përjashtuar çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë në dispozicion për observim të aseteve ose detyrimeve, drejtpërdrejt (si çmime) ose indirekt (të përbëra nga çmimet); dhe  
 Niveli 3: shënimet hyrëse për asetet e detyrimet të cilat nuk bazohen në shënimet në dispozicion për observim të tregut.

##### Instrumentet financiare që nuk janë të prezantuara sipas vlerës së drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe të drejta për ato asete dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur sipas vlerës së tyre të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023 dhe 2022.

	Niveli	Më 31 dhjetor 2023		Më 31 dhjetor 2022	
		Vlera bartëse	Vlera e drejtë	Vlera bartëse	Vlera e drejtë
		EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Mjetet financiare</b>					
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	2	152,330,062	152,330,062	32,130,471	32,130,471
Fletobligacionet e Kosovës	2	446,355,984	442,030,063	552,784,777	553,752,103
Afatizimet bankare	2	89,740,686	85,808,678	136,528,917	136,919,475
Kontributet dhe të arkëtueshmet tjera	3	19,577,370	19,577,370	16,826,228	16,826,228
		<b>739,628,277</b>	<b>699,746,173</b>	<b>738,270,393</b>	<b>739,628,277</b>
<b>Detyrimet financiare</b>					
Gjithsej detyrimet	3	1,280,462	1,280,462	876,220	876,220
		<b>1,280,462</b>	<b>1,280,462</b>	<b>876,220</b>	<b>876,220</b>

Vlera kontabël e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj, kontributeve dhe të arkëtueshme tjera, si dhe llogarive të pagueshme janë një përafrim i arsyeshëm i vlerës së tyre të drejtë për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër. Vlera e drejtë e fletobligacioneve të Kosovës dhe afatizimeve bankare vlerësohet duke skontuar në bazë të normave të interpoluara të fletobligacioneve të Kosovës për jetëgjatësitë përkatëse.

##### Instrumentet financiare të matura sipas vlerës së drejtë

Në datën e raportimit, instrumentet financiare të FKPKMP të matura sipas vlerës së drejtë paraqiten si në vijim:

Klasa e investimeve	Niveli	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
		EUR	EUR
Mjetet financiare me VDFH	1	2,013,518,138	1,689,250,011

Matjet e vlerës së drejtë të listuara sipër janë periodike. Nuk ka pasur lëvizje të mjeteve në mes të niveleve gjatë viteve që kanë përfunduar më 31 dhjetor 2023 dhe 2022. Vlerat e drejta të aseteve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohen në çmimet e marra direkt nga bursat në të cilat tregtohen ose merren instrumentet nga menaxhuesi i fondit.

##### 3.9.7 Ekspozimi përmes investimeve indirekte

Shumica e mjeteve të FKPKMP janë të investuara përmes fondeve të hapura investuese të cilat tregtojnë me klasa të ndryshme të aseteve dhe zbatojnë politika të ndryshme të investimit dhe të riskut. Si rezultat, mjetet e FKPKMP i ekspozohen rreziqeve të ndryshme për investimet indirekte varësisht nga mjetet ku investon fondi i hapur investues; ndërkohë që rreziqet kryesore të përmbledhura janë: i çmimit; Kreditor / i palës tjetër; Shtetëror/politik; i normave të interesit / valutor.

#### 4 PARAJA E GATSHME DHE EKVIVALENTËT E SAJ

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
	EUR	EUR
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	151,925,005	28,860,633
Erste Bank Austri (brokeri)	405,057	3,269,838
<b>Gjithsej paraaja e gatshme dhe ekuivalentët e saj</b>	<b>152,330,062</b>	<b>32,130,471</b>

Nga 1 janari 2022 deri më 7 gusht 2022 interesi negativ vjetor prej -0.70%; është aplikuar mbi bilansin ditor të llogarisë së FKPKMP me Bankën Qendrore të Kosovës. Nuk është ngarkuar interes për pjesën e mbetur të vitit 2022. Nga 1 janari 2023 deri më 4 gusht 2023 interesi pozitiv vjetor prej 0.25%, dhe nga 5 gushti 2023 deri më 31 dhjetor 2023 interesi pozitiv vjetor prej 0.30%, është ofruar mbi bilancin ditor në këtë llogari.

Brokeri ka ngarkuar interes negativ vjetor prej -0.60% mbi bilancin ditor prej 1 janar 2022 deri më 4 gusht 2022. Nuk është ngarkuar interes nga 5 gusht 2022 deri më 31 dhjetor 2022. Nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2023 interesi pozitiv vjetor prej 0.25% është ofruar mbi llogarinë me brokerin.

Të hyrat neto dhe (shpenzimet) neto të interesit për periudhat përkatëse ishin si në vijim:

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022
	EUR	EUR
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	123,063	(83,464)
Erste Bank Austri (brokeri)	31,564	(48,994)
<b>Gjithsej të hyrat / (shpenzimet) e interesit</b>	<b>154,627</b>	<b>(132,458)</b>

#### 5 KONTRIBUTET DHE TË ARKËTUESHMET TJERA

Kontributet e dhe të arkëtueshmet tjera më 31 dhjetor 2023 në shumë 19,577,370 EUR (2022: 16,826,228 EUR) kanë të bëjnë me kontributet të pranuar në llogarinë rrjedhëse në BQK deri më datën 18 të muajit pas datave të raportimit në shumë 19,560,192 EUR (2022: 16,826,228 EUR), si dhe interesi i arkëtueshëm nga paraaja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në shumë 17,178 EUR (2022: zero).

Ligji Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19, që ndryshon Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet pensionale në Kosovë, hyri në fuqi më 7 dhjetor 2020. Ky ndryshim lejoi tërheqjen e parakohshme të 10% të bilancit e kursimeve për të gjithë pjesëmarrësit, për një periudhë prej katër muajsh pas hyrjes në fuqi, dmth. deri në 6 prill 2021. Për më tepër, ndryshimi ka paraparë që pjesëmarrësit me bilanc kursimesh më të ulët ose të barabartë me 9,999.00 EUR (që praktikisht kanë tërhequr 999,90 EUR ose më pak), me fillim nga 2023, do të rimbursohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas mënyrës dhe orarit të rënë dakord në konsultim me FKPK-në. Pjesëmarrësit të cilët tërhoqën 999.90 EUR ose më pak numëruan 372,652, dhe tërheqjet e tyre arritën në 101,772,746 EUR. Kjo përfaqësoi borxhin fillestar të Qeverisë ndaj pjesëmarrësve.

Qeveria në vitin 2022 kishte vendosur ta rimbursojë totalin e borxhit në rata me fillim në 2023. Në vitin 2023 u nënshkrua memorandum i midis Qeverisë dhe FKPK-së që përcaktonte se prioritet për rimbursim do të ofrohej ndaj pjesëmarrësve me (1) tërheqje të përhershme; dhe (2) data më të hershme të lindjes.

Në lidhje me këtë, në korrik 2023 Qeveria pagoi këstin e parë të rimbursimit në shumë 5,431,049 EUR për gjithsej 12,090 pjesëmarrës. Në buxhetin e saj për vitin fiskal 2024, Qeveria ka alokuar 3,000,000 EUR për këstin e dytë të rimbursimit. Meqë alokimet buxhetore zakonisht janë vetëm plane fillestare, shuma e saktë do të përcaktohet në momentin kur rimbursimet bëhen.

**6 MJETET FINANCIARE ME VDFH**

**a) Investimet në fondet e hapura (në EUR)**

							2023
Fondi	Shënimi	Më 1 janar	Investimet e reja	Rritja ose ulja	Tarifat e mbajura	Tërheqjet	Më 31 dhjetor
		EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
IE00B03HD316	6.1	1,078,243	110,801,837	8,103,677	(30,018)	-	119,953,739
IE00B504KX99	6.2	200,172,086	-	(9,690,431)	-	(190,481,655)	-
LU0257969260	6.3	148,462,915	-	14,306,255	-	-	162,769,170
LU0539147214	6.4	224,068,597	-	8,066,299	-	-	232,134,896
FR0007038138	6.5	382,119,647	533,172,517	16,006,885	(258,977)	(81,999,555)	849,040,517
IE00BYX8XD24	6.6	21,339,112	-	(722,816)	(44,748)	(20,571,548)	-
US78468R5569	6.7	56,943,838	-	(1,241,047)	(196,774)	-	55,506,017
US37954Y6730	6.8	59,069,111	-	14,981,588	(305,553)	(9,999,963)	63,745,183
US46435U7138	6.9	60,062,495	-	4,576,252	(247,168)	-	64,391,579
LU0406802768	6.10	2,223,726	23,000,000	(2,998,153)	(150,100)	(22,075,473)	-
LU2305367323	6.11	1,540,491	23,000,000	3,743,154	-	-	28,283,645
US4642882249	6.12	22,171,891	-	(7,577,067)	(69,258)	(14,525,566)	-
US46138E6288	6.13	67,214,478	-	(11,396,017)	(184,077)	(24,199,933)	31,434,451
LU1390062245	6.14	75,868,822	-	1,082,704	(110,437)	(76,841,089)	-
US9229087443	6.15	118,823,433	-	(829,024)	(43,100)	(56,400,771)	61,550,538
IE00BQN1K901	6.16	79,301,062	-	10,960,895	(214,543)	-	90,047,414
LU1829219390	6.17	53,615,661	-	16,462,594	(185,046)	(46,000,605)	23,892,604
US46434V6213	6.18	55,544,738	-	1,083,522	(28,314)	(56,599,946)	-
IE00BKWQ0F09	6.19	29,529,067	-	2,290,227	(55,102)	-	31,764,192
GB00B15KYG56	6.20	30,100,598	-	(4,153,992)	(132,005)	-	25,814,601
JE00B8DFY052	6.21	-	36,999,951	3,479,125	(47,906)	(12,997,791)	27,433,379
IE00B5M1WJ87	6.22	-	20,999,983	1,044,219	(53,012)	-	21,991,190
GB00B15KXV33	6.23	-	34,999,865	(633,998)	(101,430)	-	34,264,437
US46434G8481	6.24	-	70,002,291	(8,446,783)	(181,046)	(29,401,813)	31,972,649
IE00BH04GL39	6.25	-	24,999,587	1,935,702	(4,488)	-	26,930,801
US4642885622	6.26	-	14,999,970	635,467	(5,492)	-	15,629,945
US69374H7411	6.27	-	14,999,985	(26,186)	(6,608)	-	14,967,191
<b>Gjithsej investimet në fondet e hapura</b>		<b>1,689,250,011</b>	<b>907,975,986</b>	<b>61,043,051</b>	<b>(2,655,202)</b>	<b>(642,095,708)</b>	<b>2,013,518,138</b>

Përveç fitimeve neto prej 61,043,051 EUR nga rivlerësimi i, dhe tërheqja nga, fondet e hapura, 8,140,670 EUR të tjera u pranuan si dividendë gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2023, duke bërë gjithsej fitimet neto nga fondet e hapura të jenë në vlerë prej 69,183,721 EUR.

**6 MJETET FINANCIARE ME VDFH (VAZHDIM)**

**a) Investimet në fondet e hapura (në EUR) (vazhdim)**

							2022
Fondi	Shënimi	Më 1 janar	Investimet e reja	Rritja ose ulja	Tarifat e mbajura	Tërheqjet	Më 31 dhjetor
		EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
IE00B03HD316	6.1	13,065,132	60,007,253	(5,943,033)	(53,049)	(65,998,060)	1,078,243
IE00B504KX99	6.2	367,648,407	-	(33,876,321)	-	(133,600,000)	200,172,086
LU0257969260	6.3	90,711,376	57,100,000	651,539	-	-	148,462,915
LU0539147214	6.4	359,813,946	-	(28,745,349)	-	(107,000,000)	224,068,597
FR0007038138	6.5	364,551,204	320,073,029	850,637	(155,406)	(303,199,817)	382,119,647
IE00BYX8XD24	6.6	11,346,297	20,674,993	(366,785)	(16,568)	(10,298,825)	21,339,112
US78468R5569	6.7	-	50,018,623	7,091,647	(166,432)	-	56,943,838
US37954Y6730	6.8	46,032,602	14,999,205	(1,748,977)	(213,719)	-	59,069,111
US46435U7138	6.9	44,270,331	15,190,028	788,192	(186,056)	-	60,062,495
LU0406802768	6.10	19,719,793	-	(3,054,986)	(41,081)	(14,400,000)	2,223,726
LU2305367323	6.11	20,751,368	-	(2,410,877)	-	(16,800,000)	1,540,491
US4642882249	6.12	9,706,952	23,129,608	(2,381,583)	(74,303)	(8,208,783)	22,171,891
US46138E6288	6.13	-	84,178,600	(16,738,885)	(225,237)	-	67,214,478
LU1390062245	6.14	-	131,952,780	4,025,246	(136,202)	(59,973,002)	75,868,822
US9229087443	6.15	-	116,304,097	2,552,270	(32,934)	-	118,823,433
IE00BQN1K901	6.16	-	84,290,664	(4,818,494)	(171,108)	-	79,301,062
LU1829219390	6.17	-	85,070,899	(7,220,044)	(165,126)	(24,070,068)	53,615,661
US46434V6213	6.18	-	56,810,413	(1,246,330)	(19,345)	-	55,544,738
IE00BKWQ0F09	6.19	-	29,988,626	(456,939)	(2,620)	-	29,529,067
GB00B15KYG56	6.20	-	29,988,566	118,455	(6,423)	-	30,100,598
LU0227145629		22,853,728	-	(393,667)	(5,918)	(22,454,143)	-
LU0102035119		51,971,085	-	(3,354,516)	(77,677)	(48,538,892)	-
IE00B86MWN23		15,033,404	-	(1,370,154)	(5,097)	(13,658,153)	-
US46090E1038		-	139,884,813	(4,344,676)	(68,274)	(135,471,863)	-
US91232N2071		-	46,000,197	13,733,000	(100,315)	(59,632,882)	-
LU1681041890		73,446,591	22,985,765	(10,561,869)	(45,405)	(85,825,082)	-
US33734X8469		27,402,701	-	(3,307,827)	(21,393)	(24,073,481)	-
IE00BF0M6N54		39,161,985	-	(3,408,587)	(25,998)	(35,727,400)	-
US69374H7668		33,917,670	-	(5,281,034)	(26,046)	(28,610,590)	-
US9229085538		45,947,140	-	(5,745,840)	(7,254)	(40,194,046)	-
US46140H7008		45,807,075	-	(795,250)	(276,002)	(44,735,823)	-
LU1244139827		17,969,997	2,438	(5,945,216)	(29,443)	(11,997,776)	-
LU1530899811		24,173,177	-	(4,169,362)	(66,425)	(19,937,390)	-
LU1694772994		23,919,668	14,005	(4,131,236)	(36,965)	(19,765,472)	-
LU1820776075		25,815,348	8,859	(5,078,584)	(38,531)	(20,707,092)	-
US33733E5006		13,272,814	-	(4,554,511)	(5,448)	(8,712,855)	-
LU1390062831		-	82,390,024	8,776,607	(44,562)	(91,122,069)	-
US37954Y3844		-	23,146,523	(5,912,030)	(64,516)	(17,169,977)	-
<b>Gjithsej investimet në fondet e hapura</b>		<b>1,808,309,791</b>	<b>1,494,210,008</b>	<b>(138,775,369)</b>	<b>(2,610,878)</b>	<b>(1,471,883,541)</b>	<b>1,689,250,011</b>

Përveç rënieve neto prej 138,775,369 EUR nga rivlerësimi i, dhe tërheqja nga, fondet e hapura, 5,739,074 EUR të tjera u pranuan si dividendë gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2022, duke bërë gjithsej rëniet neto nga fondet e hapura të jenë në vlerë prej 133,036,295 EUR

**6 MJETET FINANCIARE ME VDFH (VAZHDIM)**

**b) Investimet në fondet e hapura (në njësi)**

						2023	
Fondi	Shënimi	Më	Investimet e reja	Tërheqjet	Më	Më	
		1 janar			31 dhjetor	31 dhjetor	
		Njësi	Njësi	Njësi	Njësi	Çmimi (EUR)	
IE00B03HD316	6.1	44,147	4,014,995	-	4,059,142	29.55	
IE00B504KX99	6.2	132,022,218	-	(132,022,218)	-	-	
LU0257969260	6.3	3,991,701	-	-	3,991,701	40.78	
LU0539147214	6.4	10,654,206	-	-	10,654,206	21.79	
FR0007038138	6.5	367	500	(78)	789	1,076,809.39	
IE00BYX8XD24	6.6	2,776,000	-	(2,776,000)	-	-	
US78468R5569	6.7	447,928	-	-	447,928	123.92	
US37954Y6730	6.8	2,382,614	-	(338,828)	2,043,786	31.19	
US46435U7138	6.9	1,766,651	-	-	1,766,651	36.45	
LU0406802768	6.10	7,504	72,352	(79,856)	-	-	
LU2305367323	6.11	17,170	244,965	-	262,135	107.90	
US4642882249	6.12	1,193,261	-	(1,193,261)	-	12.11	
US46138E6288	6.13	1,391,035	-	(684,990)	706,045	44.52	
LU1390062245	6.14	678,612	-	(678,612)	-	-	
US9229087443	6.15	904,511	-	(449,634)	454,877	135.31	
IE00BQN1K901	6.16	11,323,870	-	-	11,323,870	7.95	
LU1829219390	6.17	541,370	-	(356,100)	185,270	128.96	
US46434V6213	6.18	1,187,125	-	(1,187,125)	-	-	
IE00BKWQ0F09	6.19	162,910	-	-	162,910	194.98	
GB00B15KYG56	6.20	1,972,387	-	-	1,972,387	13.09	
JE00B8DFY052	6.21	-	3,497,987	(1,131,000)	2,366,987	11.59	
IE00B5M1WJ87	6.22	-	966,221	-	966,221	22.76	
GB00B15KXV33	6.23	-	4,160,325	-	4,160,325	8.24	
US46434G8481	6.24	-	1,656,100	(835,924)	820,176	38.98	
IE00BH04GL39	6.25	-	1,146,870	-	1,146,870	23.48	
US4642885622	6.26	-	234,885	-	234,885	66.54	
US69374H7411	6.27	-	554,730	-	554,730	26.98	



**6 MJETET FINANCIARE ME VDFH (VAZHDIM)**

**b) Investimet në fondet e hapura (në njësi) (vazhdim)**

						2022
Fondi	Shënimi	Më	Investimet e reja	Tërheqjet	Më	Më
		1 janar			31 dhjetor	
		Njësi	Njësi	Njësi	Njësi	Çmimi (EUR)
IE00B03HD316	6.1	437,239	2,297,752	(2,690,844)	44,147	24.42
IE00B504KX99	6.2	217,646,464	-	(85,624,246)	132,022,218	1.52
LU0257969260	6.3	2,435,859	1,555,842	-	3,991,701	37.19
LU0539147214	6.4	15,878,815	-	(5,224,609)	10,654,206	21.03
FR0007038138	6.5	350	308	(291)	367	1,041,677.63
IE00BYX8XD24	6.6	1,259,021	2,776,000	(1,259,021)	2,776,000	7.69
US78468R5569	6.7	-	447,928	-	447,928	127.13
US37954Y6730	6.8	1,811,158	571,456	-	2,382,614	24.79
US46435U7138	6.9	1,320,435	446,216	-	1,766,651	34.00
LU0406802768	6.10	52,375	-	(44,871)	7,504	296.33
LU2305367323	6.11	204,987	-	(187,817)	17,170	89.72
US4642882249	6.12	520,900	1,193,261	(520,900)	1,193,261	18.58
US46138E6288	6.13	-	1,391,035	-	1,391,035	48.32
LU1390062245	6.14	-	1,231,612	(553,000)	678,612	111.80
US9229087443	6.15	-	904,511	-	904,511	131.37
IE00BQN1K901	6.16	-	11,323,870	-	11,323,870	7.00
LU1829219390	6.17	-	812,055	(270,685)	541,370	99.04
US46434V6213	6.18	-	1,187,125	-	1,187,125	46.79
IE00BKWQ0F09	6.19	-	162,910	-	162,910	181.26
GB00B15KYG56	6.20	-	1,972,387	-	1,972,387	15.26
LU0227145629		126,852	-	(126,852)	-	-
LU0102035119		297,675	-	(297,675)	-	-
IE00B86MWN23		265,102	-	(265,102)	-	-
US46090E1038		-	455,433	(455,433)	-	-
US91232N2071		-	877,113	(877,113)	-	-
LU1681041890		700,000	239,563	(939,563)	-	-
US33734X8469		590,320	-	(590,320)	-	-
IE00BF0M6N54		2,565,980	-	(2,565,980)	-	-
US69374H7668		684,563	-	(684,563)	-	-
US9229085538		449,961	-	(449,961)	-	-
US46140H7008		2,342,970	-	(2,342,970)	-	-
LU1244139827		525,765	87	(525,852)	-	-
LU1530899811		107	-	(107)	-	-
LU1694772994		108,887	74	(108,961)	-	-
LU1820776075		1,199,041	506	(1,199,547)	-	-
US33733E5006		179,420	-	(179,420)	-	-
LU1390062831		-	817,200	(817,200)	-	-
US37954Y3844		-	789,552	(789,552)	-	-

**6 MJETET FINANCIARE ME VDFH (VAZHDIM)**

**c) Tarifat dhe rabatet e instrumenteve për investime të hapura**

		Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023			Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022		
		Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto	Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto
		EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
IE00B03HD316	6.1	30,018	(4,707)	25,311	53,049	(7,709)	45,340
IE00B504KX99	6.2	1,032,156	-	1,032,156	1,482,878	-	1,482,878
LU0257969260	6.3	670,184	-	670,184	517,879	-	517,879
LU0539147214	6.4	1,279,152	-	1,279,152	1,571,199	-	1,571,199
FR0007038138	6.5	258,977	(163,614)	95,363	155,406	(103,042)	52,364
IE00BYX8XD24	6.6	44,748	-	44,748	16,568	-	16,568
US78468R5569	6.7	196,774	-	196,774	166,432	-	166,432
US37954Y6730	6.8	305,553	-	305,553	213,719	-	213,719
US46435U7138	6.9	247,168	-	247,168	186,056	-	186,056
LU0406802768	6.10	150,100	(72,086)	78,014	41,081	(19,875)	21,206
LU2305367323	6.11	114,066	(115)	113,951	23,844	-	23,844
US4642882249	6.12	69,258	-	69,258	74,303	-	74,303
US46138E6288	6.13	184,077	-	184,077	225,237	-	225,237
LU1390062245	6.14	110,437	-	110,437	136,202	-	136,202
US9229087443	6.15	43,100	-	43,100	32,934	-	32,934
IE00BQN1K901	6.16	214,543	-	214,543	171,108	-	171,108
LU1829219390	6.17	185,046	-	185,046	165,126	-	165,126
US46434V6213	6.18	28,314	-	28,314	19,345	-	19,345
IE00BKWQ0F09	6.19	55,102	-	55,102	2,620	-	2,620
GB00B15KYG56	6.20	132,005	-	132,005	6,423	-	6,423
JE00B8DFY052	6.21	47,906	-	47,906	-	-	-
IE00B5M1WJ87	6.22	53,012	-	53,012	-	-	-
GB00B15KXV33	6.23	101,430	-	101,430	-	-	-
US46434G8481	6.24	181,046	-	181,046	-	-	-
IE00BH04GL39	6.25	4,488	-	4,488	-	-	-
US4642885622	6.26	5,492	-	5,492	-	-	-
US69374H7411	6.27	6,608	-	6,608	-	-	-
LU0227145629	-	-	-	-	5,918	-	5,918
LU0102035119	-	-	-	-	77,677	(20,698)	56,979
IE00B86MWN23	-	-	-	-	5,097	-	5,097
US46090E1038	-	-	-	-	68,274	-	68,274
US91232N2071	-	-	-	-	100,315	-	100,315
LU1681041890	-	-	-	-	45,405	-	45,405
US33734X8469	-	-	-	-	21,393	-	21,393
IE00BF0M6N54	-	-	-	-	25,998	-	25,998
US69374H7668	-	-	-	-	26,046	-	26,046
US9229085538	-	-	-	-	7,254	-	7,254
US46140H7008	-	-	-	-	276,002	-	276,002
LU1244139827	-	-	-	-	29,443	(1,088)	28,355
LU1530899811	-	-	-	-	66,425	-	66,425
LU1694772994	-	-	-	-	36,965	(6,947)	30,018
LU1820776075	-	-	-	-	38,531	(6,736)	31,795
US33733E5006	-	-	-	-	5,448	-	5,448
LU1390062831	-	-	-	-	44,562	-	44,562
US37954Y3844	-	-	-	-	64,516	-	64,516
<b>Gjithsej tarifa e rabate</b>		<b>5,750,760</b>	<b>(240,522)</b>	<b>5,510,238</b>	<b>6,206,678</b>	<b>(166,095)</b>	<b>6,040,583</b>

**6 MJETET FINANCIARE ME VDFH (VAZHDIM)**

**d) Përshkrim i fondeve të hapura me plasmane gjatë vitit**

Fondi	Klasa e asetit	Strategjia	Tarifat
6.1 Vanguard Investment Series plc - Global Stock Index Fund Euro hedged  ISIN: IE00B03HD316	Aksione	Ndjek indeksin MSCI World	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.18% p.v. Ofron rabat deri në 0.11% p.v. varësisht mjeteve (2022: 0.18% p.v.)
6.2 BNY Mellon - Real Return Fund  ISIN: IE00B504KX99	Asete mikse	Kthim absolut nga kombinim i keshit, oqigacioneve, arit, dhe aksioneve	Faturohet me normë 0.54%-0.63% p.v. varësisht mjeteve (2022: 0.54-0.63% p.v.)
6.3 Nordea 1 – Global Stable Equity Fund  ISIN: LU0257969260	Aksione	Aksione “vlerë” dhe “cilësi” me menaxhim risku	Faturohet me normë 0.43% p.v. (2022: 0.43% p.v.)
6.4 Nordea 1 –Stable Return Fund X EUR  ISIN: LU0539147214	Asete mikse	Kombinim i keshit, oqigacioneve dhe aksioneve me përdorim derivatesh kundër rreziqeve	Faturohet me normë 0.56% p.v. (2022: 0.56% p.v.)
6.5 Amundi – 3M (I)  ISIN: FR000703813	Kesh	Instrumente te tregut të parasë me likuiditet dhe siguri të lartë	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.057% p.v. Jep rabat 0.012% p.v. për mjetet mbi 50,000,000 EUR (2022: 0.057% p.v.)
6.6 iShares Edge S&P 500 Minimum Volatility UCITS ETF EUR Hedged (Acc)  ISIN: IE00BYX8XD24	Aksione	Aksione të S&P500 me luhatshmëri më të ulët	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.25% p.v. (2022: 0.25% p.v.)
6.7 SPDR® S&P Oil & Gas Exploration & Production ETF  ISIN: US78468R5569	Aksione	Energji	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.35% p.v. (2022: 0.35% p.v.)
6.8 Global X U.S. Infra-structure Development ETF  ISIN: US37954Y6730	Asete reale	Infrastrukturë	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.47% p.v. (2022: 0.47% p.v.)
6.9 iShares U.S. Infrastructure ETF  ISIN: US46435U7138	Asete reale	Infrastrukturë	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.40% p.v. (2022: 0.40% p.v.)
6.10 BNP Paribas Funds Climate Impact  ISIN: LU0406802768	Aksione	Qëndrueshmëri	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.885% p.v. Ofron rabat deri në 0.386% p.v. varësisht mjeteve (2022: 0.885% p.v.)

**6 MJETET FINANCIARE ME VDFH (VAZHDIM)**

**d) Përshkrim i fondeve të hapura me plasmane gjatë vitit**

Fondi	Klasa e asetit	Strategjia	Tarifat
6.11 Schroder ISF Global Sustainable Growth  ISIN: LU2305367323	Aksione	Qëndrueshmëri	Faturohet me normë 0.50% p.v. (2022: 0.50% p.v.)
6.12 iShares Global Clean Energy ETF  ISIN: US4642882249	Aksione	Energji	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.42% p.v. (2022: 0.42% p.v.)
6.13 Invesco KBW Bank ETF  ISIN: US46138E6288	Aksione	Aksione "vlerë"	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.35% p.v. (2022: 0.35% p.v.)
6.14 Lyxor EUR 2-10Y Inflation Expectations UCITS ETF  ISIN: LU1390062245	Instrumente borxhi	Obligacione të lidhura për inflacion	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.25% p.v. (2022: 0.25% p.v.)
6.15 Vanguard Value Index Fund ETF  ISIN: US9229087443	Aksione	Aksione "vlerë"	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.04% p.v. (2022: 0.04% p.v.)
6.16 iShares Edge MSCI Europe Value Factor UCITS ETF  ISIN: IE00BQN1K901	Aksione	Aksione "vlerë"	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.25% p.v. (2022: 0.25% p.v.)
6.17 Lyxor EURO STOXX Banks (DR) UCITS ETF  ISIN: LU1829219390	Aksione	Aksione "vlerë"	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.30% p.v. (2022: 0.30% p.v.)
6.18 iShares Core Dividend Growth ETF  ISIN: US46434V6213	Aksione	Të ardhura	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.08% p.v. (2022: 0.08% p.v.)
6.19 SPDR MSCI Europe Energy UCITS ETF  ISIN: IE00BKWQ0F09	Aksione	Energji	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.18% p.v. (2022: 0.18% p.v.)
6.20 WisdomTree Industrial Metals ETF  ISIN: GB00B15KYG56	Asete reale	Metale	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.49% p.v. (2022: 0.49% p.v.)

**6 MJETET FINANCIARE ME VDFH (VAZHDIM)**

**d) Përshkrim i fondeve të hapura me plasmane gjatë vitit**

Fondi	Klasa e asetit	Strategjia	Tarifat
6.21 WisdomTree Physical Gold - EUR Daily Hedged ETC ISIN: JE00B8DFY052	Asete reale	Metale	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.15% p.v. (2022: n/a)
6.22 SPDR S&P Euro Dividend Aristocrats UCITS ETF  ISIN: IE00B5M1WJ87	Aksione	Dividendë	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.30% p.v. (2022: n/a)
6.23 WisdomTree WTI Crude Oil ETF  ISIN: GB00B15KXV33	Asete reale	Energji	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.49% p.v. (2022: n/a)
6.24 iShares MSCI Global Metals & Mining Producers ETF ISIN: US46434G8481	Aksione	Metale dhe miniera	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.39% p.v. (2022: n/a)
6.25 EUR Eurozone Government Bond UCITS ETF ISIN: IE00BH04GL39	Instrumente borxhi	Fletobligacione thesaresh	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.07% p.v. (2022: n/a)
6.26 iShares Residential and Multisector Real Estate ETF ISIN: US4642885622	Asete reale	Patundshmëri	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.48% p.v. (2022: n/a)
6.27 Pacer Benchmark Data & Infrastructure Real Estate ETF ISIN: US69374H7411	Asete reale	Patundshmëri	Ndalet çdo ditë nga fondi me normë 0.60% p.v. (2022: n/a)

**7 FLETOBLIGACIONET E KOSOVËS DHE AFATIZIMET BANKARE**

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
	EUR	EUR
<b>Fletobligacionet e Kosovës</b>		
Para provizioneve për humbjet e pritura kreditore	447,135,505	553,752,103
Provizionet për humbjet e pritura kreditore	(779,521)	(967,326)
<b>Pas provizioneve për humbjet e pritura kreditore</b>	<b>446,355,984</b>	<b>552,784,777</b>
<b>Afatizimet bankare</b>		
Para provizioneve për humbjet e pritura kreditore	90,088,204	136,919,475
Provizionet për humbjet e pritura kreditore	(347,518)	(390,558)
<b>Pas provizioneve për humbjet e pritura kreditore</b>	<b>89,740,686</b>	<b>136,528,917</b>
<b>Fletobligacionet e Kosovës dhe afatizimet bankare</b>	<b>536,096,670</b>	<b>689,313,694</b>

Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 për instrumentet e sipërme ishin:

	Fletobligacione të Kosovës	Afatizimet bankare	Instrumentet e borxhit
	EUR	EUR	EUR
<b>Më 1 janar 2022</b>	<b>245,753</b>	<b>26,866</b>	<b>272,619</b>
Shtesat në provizione nga plasmanet e reja	270,488	309,638	580,126
Shtesat në provizione nga ndryshimi i parametrave të riskut	489,340	68,909	558,249
Lirimi i provizioneve për shkak të maturimit / çnjohjes	(38,255)	(14,855)	(53,110)
<b>Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore</b>	<b>721,573</b>	<b>363,692</b>	<b>1,085,265</b>
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>967,326</b>	<b>390,558</b>	<b>1,357,884</b>
Shtesat në provizione nga plasmanet e reja	70,873	224,164	295,037
Lirimi i provizioneve për shkak të maturimit / neto çnjohjeve	(258,678)	(267,204)	(525,882)
<b>Lëvizjet neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore</b>	<b>(187,805)</b>	<b>(43,040)</b>	<b>(230,845)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>779,521</b>	<b>347,518</b>	<b>1,127,039</b>

## 7 FLETOBLIGACIONET E KOSOVËS DHE AFATIZIMET BANKARE (VAZHDIM)

Më 31 dhjetor 2023, investimet e FKPKMP në instrumentet e borxhit të Thesarit të Kosovës të matura me kosto të amortizuar, përbëheshin nga 36 letra me vlerë me sasi nominale prej 442,630,000 EUR, me afat origjinal të maturimit prej 12 muaj deri në 10 vjet, jetëgjatësi të mbetur mesatare (të ponderuar) prej 2.95 vjetësh dhe normë mesatare / kupon (të ponderuar) prej 2.92%. Më 31 dhjetor 2022 ato përbëheshin nga 41 letra me vlerë me sasi nominale prej 548,420,000 EUR, me afat origjinal të maturimit prej 12 muaj deri në 10 vjet, jetëgjatësi të mbetur mesatare (të ponderuar) prej 2.99 vjetësh dhe normë mesatare / kupon (të ponderuar) prej 2.61%.

Më 31 dhjetor 2023 investimet e FKPKMP në depozitat bankare me afat të matura me koston e amortizuar përbëheshin nga 7 depozita me afat origjinal të maturimit midis 1 dhe 2 vjet, norma fikse të interesit, jetëgjatësi të mbetur mesatare (të ponderuar) prej 1.33 vjetësh dhe normë mesatare të interesit prej 3.35%. Më 31 dhjetor 2022, investimet në depozitat me afat matur me koston e amortizuar përbëheshin nga 12 depozita me afat origjinal të maturimit midis 1 dhe 2 vjet, norma fikse të interesit, jetëgjatësi të mbetur mesatare (të ponderuar) prej 1.01 vjetësh dhe normë mesatare të interesit prej 2.26%.

	Fletobligacione të Kosovës	Afatizimet bankare	Instrumentet e borxhit
	EUR	EUR	EUR
<b>Më 1 janar 2022</b>	<b>491,257,920</b>	<b>44,749,329</b>	<b>536,007,249</b>
Plasmanet e reja	138,402,081	125,602,002	264,004,083
Interesi i fituar	13,005,284	1,282,066	14,287,350
Interesi / kuponët e pranuar	(12,828,935)	(665,877)	(13,494,812)
Kryegjësja e maturuar	(76,330,000)	(34,074,911)	(110,404,911)
Lëvizja neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore	(721,573)	(363,692)	(1,085,265)
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>552,784,777</b>	<b>136,528,917</b>	<b>689,313,694</b>
Plasmanet e reja	34,569,871	54,000,000	88,569,871
Interesi i fituar	13,267,861	3,057,336	16,325,197
Interesi / kuponët e pranuar	(13,984,330)	(2,447,605)	(16,431,935)
Kryegjësja e maturuar	(140,470,000)	(101,441,002)	(241,911,002)
Lëvizja neto në provizionet për humbjet e pritura kreditore	187,805	43,040	230,845
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>446,355,984</b>	<b>89,740,686</b>	<b>536,096,670</b>

## 8 DETYRIMET NDAJ FKPKOP

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
	EUR	EUR
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve - të pagueshme	570,836	564,690
Plus / (Minus): Diferenca nga refondimet e kontributeve të gabuara	10,261	(11)
<b>Detyrimet ndaj FKPKOP</b>	<b>581,097</b>	<b>564,679</b>

**9 DETYRIMET TJERA**

Shënime	Më	Më	
	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022	
	EUR	EUR	
Detyrimet për tërheqje të kursimeve	3.4	608,352	233,782
Detyrimet për refondime	3.4	-	2,615
Detyrimet për jo-kontributet	3.6	91,013	75,144
<b>Gjithsej detyrimet tjera</b>		<b>699,365</b>	<b>311,541</b>

**10 TË HYRAT E TJERA**

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2023 Bordi Drejtues i FKPK-së vendosi t'i kthejë tek fondi pensional 2,000,000 EUR nga suficiti i aktiviteteve investuese i FKPKOP (2022: zero).

**11 TARIFAT E NGARKUARA MBI LLOGARITË E Pjesëmarrësve**

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022
	EUR	EUR
Tarifa për aktivitetet investuese	8,132,780	7,511,466
Tarifa për aktivitetet operacionale	1,288,637	1,337,980
<b>Gjithsej tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve</b>	<b>9,421,417</b>	<b>8,849,446</b>

Gjithsej tarifa e ngarkuara në baza ditore me qëllim të financimit të aktiviteteve të FKPKOP, siç është shpalosur në Shënimin 3.5 të këtyre pasqyrave financiare. Tarifat e aplikuara vjetore për periudhën e raportimit, siç janë miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-168, ishin si në vijim:

Prej	Deri	Tarifa për aktivitetet investuese	Tarifa për aktivitetet operacionale	Gjithsej Tarifat
1 janar 2022	7 shkurt 2023	0.320% p.v.	0.057% p.v.	0.377% p.v.
8 shkurt 2023	31 dhjetor 2023	0.320% p.v.	0.050% p.v.	0.370% p.v.



**12 LLOGARITË INDIVIDUALE TË PJESËMARRËSVE**

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
	Numri i llogarive	Numri i llogarive
Llogari pa tërheqje të përhershme të kursimeve	760,990	725,766
Llogari me tërheqje të përhershme të kursimeve	73,973	67,229
<b>Gjithsej llogari</b>	<b>834,963</b>	<b>792,995</b>

Një llogari me tërheqje të përhershme të kursimeve paraqet llogaritë e kursimeve pensionale prej të cilave janë tërhequr kursimet pensionale për shkak se: (i) pjesëmarrësi ka arritur moshën e pensionimit (65 vjeçare) ose është bërë i paaftë për punë, ose (ii) pasardhësit, të konsideruar si trashëgimtarë të ligjshëm, kanë trashëguar kursimet pensionale të pjesëmarrësit të vdekur. Nga 834,963 pjesëmarrësit për të cilët FKPK-ja kishte hapur llogari të kursimeve pensionale deri në datën e raportimit, 442,383 sosh kishin kontribute që i përkisnin vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2023 (2022: 428,891 nga 792,995 llogaritë e hapura).

Kontributet në FKPK paguhen nga punëdhënësit në emër të të punësuarve të cilët janë rezidentë të Kosovës, me normën e kontributit prej së paku 5% të të ardhurave bruto të punonjësit për të dy, punëdhënësin dhe të punësuarin. Së bashku me kontributet vullnetare, maksimumi që punëdhënësi dhe i punësuarit secili mund të kontribuojnë është 15% e të ardhurave bruto të punonjësit.

Punëdhënësit kanë për obligim të ngarkojnë në portalin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) listën e pagave në mënyrë që të sigurojnë fletëpagesën për një muaj të caktuar. Të vetëpunësuarit i bëjnë pagesat në baza tremujore. ATK-ja i mundëson FKPK-së të ketë qasje në këto shënime duke qenë gjithashtu përgjegjëse për përmbushjen e obligimeve të punëdhënësve, si dhe për sforcimin e përmbushjes përmes lëshimit të gjobave ndaj punëdhënësve delikuentë.

Prejse portali i ATK-së për deklaram elektronik u iniciua dhe u bë obligativ në vitin 2012, shumica e kontributeve shpërndahen në llogari individuale që në tentimin e parë. Megjithatë, në disa raste, pagesa e kontributeve të bëra nga punëdhënësit nuk shoqërohet me informacion të saktë dhe / ose të mjaftueshëm; duke rezultuar në kontribute jo të alokuara në llogaritë individuale të pjesëmarrësve.

Kontributet e pa alokuara më 31 dhjetor 2023 arritën në 3,192,323 EUR (2022: 2,950,426 EUR). Arsyet kryesore përfshijnë: (i) punëdhënësi ka bërë pagesën, por nuk ka dorëzuar listën e kontribuesve; (ii) punëdhënësi ka dorëzuar listën e kontribuesve, por bën nënpagesë dhe / ose mbipagesë; (iii) informacioni personal i kontribuesve në listën e kontribuesve (ID dhe / ose emri) nuk është i vlefshëm; (iv) gjobat dhe interesat për pagesa të vonuara (që i paguhen ATK-së) përfshihen në pagesa; dhe (v) burimi i pagesës (punëdhënësi) nuk është identifikuar ende.

Administrata e FKPK-së bën çmos për të zgjidhur rastet e kontributeve të paalokuara. Nëse megjithatë, kanë kaluar gjashtë ose më shumë vite nga pagesa e kontributit dhe përkundër përpjekjeve më të mira të administratës kontributi mbetet i pa alokuar, paragrafi 3 i nenit 3 të Ligjit Nr. 05/L-116 për ndryshimin e paragrafit 7.11 të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë, lejon riblerjen e njësive të kontributeve të tilla dhe vlerat që rezultojnë nga tërheqjet e tilla t'i paguhen Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) përmes Administratës Tatimore të Kosovës. Gjatë vitit 2023 nuk kishte riblerje sipas këtij provizioni, duke bërë që vlerat për bartje në BKK të jenë zero EUR (2022: zero EUR).

Gjithsej kontributet e paalokuara si përqindje e gjithsej kontributeve të arkëtuara paraqiten në vijim:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
	EUR	EUR
Kontributet e paalokuara (të njësuar në datën e raportimit)	3,192,323	2,950,426
Kontributet kumulative të njësuar deri në datën e raportimit	2,716,896,334	2,430,714,987
<b>Kontributet e paalokuara si përqindje e kontributeve të njësuar deri në datën e raportimit</b>	<b>0.117%</b>	<b>0.121%</b>

## 12 LLOGARITË INDIVIDUALE TË PJESËMARRËSVE (VAZHDIM)

Një metodë tjetër e vrojtimit të progresit të procesit të alokimit është krahasimi i fondeve të alokuara dhe mjeteve neto nën menaxhim të njësuara, si në vijim:

	Shënime	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
		Vlera në EUR	Vlera në EUR
Mjetet neto të pjesëmarrësve		2,720,241,778	2,426,644,184
<i>Përshtatur për:</i>			
Kontributet e arkëtueshme të panjësuar në datën e raportimit	5	(19,560,192)	(16,826,103)
Bilancin e provizionit për humbjet e pritura kreditore	7	1,127,039	1,357,884
<b>Mjetet neto të njësuara të pjesëmarrësve</b>		<b>2,701,808,625</b>	<b>2,411,175,965</b>
Bilanci i fondeve në llogaritë individuale		2,698,237,563	2,407,987,792
<b>Përqindja e mjeteve neto të njësuara të pjesëmarrësve në llogaritë individuale</b>		<b>99.87%</b>	<b>99.87%</b>

Mjetet neto të njësuara të pjesëmarrësve më 31 dhjetor 2023 në shumë 2,701,808,625 EUR përbëhen nga asetet e Portfolios Standarde në shumë 2,570,540,693 EUR dhe nga asetet e Portfolios Konservative në shumë 131,267,932 EUR (2022: 2,411,175,965 EUR, 2,316,363,922 EUR, përkatësisht 94,812,043 EUR).

Në datën e raportimit, bilanci i provizionit për humbjet e pritura kreditore në shumë 1,127,039 EUR përbëhet nga provizione në shumë 865,608 EUR që i përkasin Portfolios Standarde dhe 261,431 EUR asaj Konservative (2022: 272,619 EUR, 272,619 EUR, përkatësisht 188,200 EUR).

### 13 SEGMENTET OPERACIONALE

Mjetet e FKPKMP janë të ndara në dy nënportofole, Portfolio Standard dhe Portfolio Konservative, e që përbëjnë segmentet e raportueshme të saj. Çdo segment menaxhohet veçmas pasi ato kanë objektiva dhe strategji të ndryshme investimi dhe përmbajnë investime në produkte të ndryshme. Bordi Drejtues shqyrton strategjinë dhe raportet e çdo nënportofoli të paktën çdo tremujor.

Më poshtë janë shpalosur pasqyrat në lidhje me secilin prej portfoliove më dhe për vitet e përfunduara në datat e raportimit.

#### a) Pasqyra e pozicionit financiar

	Më 31 dhjetor 2023		
	Standard	Konservative	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
<b>Mjetet</b>			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	149,885,007	2,445,055	152,330,062
Kontributet dhe të arkëtueshmet tjera	19,576,715	655	19,577,370
Mjetet financiare me VDFH	2,013,518,138	-	2,013,518,138
Fletobligacionet e Kosovës	317,205,897	129,150,087	446,355,984
Afatizimet bankare	89,740,686	-	89,740,686
<b>Gjithsej mjetet</b>	<b>2,589,926,443</b>	<b>129,150,087</b>	<b>2,721,522,240</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrimet ndaj FKPKOP	539,694	41,403	581,097
Detyrimet tjera	151,472	547,893	699,365
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>691,166</b>	<b>589,296</b>	<b>1,280,462</b>
<b>Mjetet neto të pjesëmarrësve</b>	<b>2,589,235,277</b>	<b>128,560,791</b>	<b>2,720,241,778</b>

	Më 31 dhjetor 2022		
	Standard	Konservative	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
<b>Mjetet</b>			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	149,885,007	2,445,055	152,330,062
Kontributet dhe të arkëtueshmet tjera	19,576,715	655	19,577,370
Mjetet financiare me VDFH	2,013,518,138	-	2,013,518,138
Fletobligacionet e Kosovës	317,205,897	129,150,087	446,355,984
Afatizimet bankare	89,740,686	-	89,740,686
<b>Gjithsej mjetet</b>	<b>2,589,926,443</b>	<b>129,150,087</b>	<b>2,721,522,240</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrimet ndaj FKPKOP	539,694	41,403	581,097
Detyrimet tjera	151,472	547,893	699,365
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>691,166</b>	<b>589,296</b>	<b>1,280,462</b>
<b>Mjetet neto të pjesëmarrësve</b>	<b>2,589,235,277</b>	<b>128,560,791</b>	<b>2,720,241,778</b>

13 **SEGMENTET OPERACIONALE (VAZHDIM)**

b) **Pasqyra të ardhurave gjithëpërfshirëse**

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023		
	Standard	Konservative	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
<b>Të hyrat</b>			
Neto fitimet nga mjetet financiare me VDFH	61,043,051	-	61,043,051
Neto të hyrat nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e normës efektive të interesit	11,923,024	4,556,800	16,479,824
Të hyrat nga dividendat	8,140,670	-	8,140,670
Të hyrat e tjera	2,000,000	-	2,000,000
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>83,106,745</b>	<b>4,556,800</b>	<b>87,663,545</b>
<b>Shpenzimet operationale</b>			
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	(8,956,113)	(465,304)	(9,421,417)
<b>Gjithsej shpenzimet operationale</b>	<b>(8,956,113)</b>	<b>(465,304)</b>	<b>(9,421,417)</b>
Neto lirim / (ngarkesa) e humbjeve të pritura kreditore	304,076	(73,231)	230,845
<b>Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve</b>	<b>74,454,708</b>	<b>4,018,265</b>	<b>78,472,973</b>

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022		
	Standard	Konservative	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
<b>Të hyrat</b>			
Neto humbjet nga mjetet financiare me VDFH	(138,775,369)	-	(138,775,369)
Neto të hyrat nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e normës efektive të interesit	11,435,769	2,719,123	14,154,892
Të hyrat nga dividendat	5,739,074	-	5,739,074
<b>Gjithsej të hyrat / (humbjet)</b>	<b>(121,600,526)</b>	<b>2,719,123</b>	<b>(118,881,403)</b>
<b>Shpenzimet operationale</b>			
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	(8,565,968)	(283,478)	(8,849,446)
<b>Gjithsej shpenzimet operationale</b>	<b>(8,565,968)</b>	<b>(283,478)</b>	<b>(8,849,446)</b>
Neto ngarkesa e humbjeve të pritura kreditore	(897,065)	(188,200)	(1,085,265)
<b>(Rënia) / Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve</b>	<b>(131,063,559)</b>	<b>2,247,445</b>	<b>(128,816,114)</b>

13 **SEGMENTET OPERACIONALE (VAZHDIM)**

c) **Pasqyra e ndryshimeve në mjetet neto të pjesëmarrësve**

	Standard	Konservative	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR
<i>Më 1 janar 2022</i>			
Kontributet	1,768,201,944	-	1,768,201,944
Fitimet e mbajtura	598,470,415	-	598,470,415
<b>Gjithsej më 1 janar 2022</b>	<b>2,366,672,359</b>	<b>-</b>	<b>2,366,672,359</b>
<i>Lëvizja e kontributeve për shkak të:</i>			
Kontributeve të reja	244,518,592	-	244,518,592
Tërheqjes së kursimeve	(10,448,147)	(30,303,192)	(40,751,339)
Refondimeve	(862,652)	-	(862,652)
Transfereve në mes të portfoliove	(100,412,051)	100,412,051	-
<b>Lëvizja neto e kontributeve</b>	<b>132,795,742</b>	<b>70,108,859</b>	<b>202,904,601</b>
<i>Lëvizja në fitimet e mbajtura për shkak të:</i>			
Tërheqjes së kursimeve	(3,140,649)	(10,979,303)	(14,119,952)
Refondimeve	3,290	-	3,290
Transfereve në mes të portfoliove	(33,246,842)	33,246,842	-
(Rënia) / Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	(131,063,559)	2,247,445	(128,816,114)
<b>Lëvizja neto e fitimeve të mbajtura</b>	<b>(167,447,760)</b>	<b>24,514,984</b>	<b>(142,932,776)</b>
<i>Më 31 dhjetor 2022</i>			
Kontributet	1,900,997,686	70,108,859	1,971,106,545
Fitimet e mbajtura	431,022,655	24,514,984	455,537,639
<b>Gjithsej më 31 dhjetor 2022</b>	<b>2,332,020,341</b>	<b>94,623,843</b>	<b>2,426,644,184</b>
<i>Lëvizja e kontributeve për shkak të:</i>			
Kontributeve të reja	288,915,435	-	288,915,435
Tërheqjes së kursimeve	(7,992,959)	(46,228,478)	(54,221,437)
Refondimeve	(2,175,945)	-	(2,175,945)
Transfereve në mes të portfoliove	(75,382,420)	75,382,420	-
<b>Lëvizja neto e kontributeve</b>	<b>203,364,111</b>	<b>29,153,942</b>	<b>232,518,053</b>
<i>Lëvizja në fitimet e mbajtura për shkak të:</i>			
Tërheqjes së kursimeve	(1,347,750)	(16,037,229)	(17,384,979)
Refondimeve	(8,453)	-	(8,453)
Transfereve në mes të portfoliove	(19,151,773)	19,151,773	-
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	74,454,708	4,018,265	78,472,973
<b>Lëvizja neto e fitimeve të mbajtura</b>	<b>53,946,732</b>	<b>7,132,809</b>	<b>61,079,541</b>
<i>Më 31 dhjetor 2023</i>			
Kontributet	2,104,361,797	99,262,801	2,203,624,598
Fitimet e mbajtura	484,969,387	31,647,793	516,617,180
<b>Gjithsej më 31 dhjetor 2023</b>	<b>2,589,331,184</b>	<b>130,910,594</b>	<b>2,720,241,778</b>

13 **SEGMENTET OPERACIONALE (VAZHDIM)**

d) **Ekspozimi dhe kufizimet sipas llojit të investimit dhe strategjisë së kthimit**

	Më 31 dhjetor 2023		Më 31 dhjetor 2022	
	Kufiri	Alokimi	Kufiri	Alokimi
	%	%	%	%
<b>PORTFOLIO STANDARD</b>				
<i>Sipas llojit të investimit</i>				
Fonde të aksioneve	0-60	25.6	0-60	28.4
Asete reale	0-20	9.6	0-20	6.4
Fonde me multi-asete	0-55	9.0	0-55	18.4
Instrumente borxhi	0-60	16.9	0-60	29.0
Paraja e gatshme dhe tregjet e parasë	0-50	38.9	0-50	17.8
<i>Sipas strategjisë së kthimit</i>				
Kthim drejtimor (pa përshtatje për risk)	0-60	29.1	0-60	25.1
Target risku/Menaxhim risku/Kthim absolut	0-70	15.4	0-70	28.9
Kesh dhe të ardhura	0-70	55.5	0-70	46.0
<b>PORTFOLIO KONSERVATIVE</b>				
<i>Sipas llojit të investimit</i>				
Instrumente borxhi	90-99	98.2	90-99	99.0
Paraja e gatshme dhe tregjet e parasë	1-10	1.8	1-10	1.0
<i>Sipas strategjisë së kthimit</i>				
Kesh dhe të ardhura	100	100.0	100	100.0

#### 14 PASQYRA E LËVIZJEVE SË NJËSIVE TË PJESËMARRËSVE

	Shënime	2023	2022
		Njësitë	Njësitë
<b>Portfolio Standarde</b>			
<b>Më 1 janar</b>		<b>1,423,896,790</b>	<b>1,366,352,723</b>
Njësitë e emetuara për kontributet e arkëtuara		173,927,369	146,592,119
Njësitë e riblera për shkak të tërheqjeve të kursimeve		(5,667,595)	(8,175,749)
Njësitë e riblera për shkak të refondimeve		(1,325,537)	(517,846)
Neto lëvizja e njësive për shkak të transfereve ndër portfolio		(57,472,537)	(80,354,457)
<b>Më 31 dhjetor</b>		<b>1,533,358,490</b>	<b>1,423,896,790</b>
Neto mjetet e njësuar të pjesëmarrësve	12	2,570,540,693	2,316,363,922
<b>Vlera e mjeteve neto për njësi në datën e raportimit</b>		<b>EUR 1.6764</b>	<b>EUR 1.6268</b>
		Njësitë	Njësitë
<b>Portfolio Konservative</b>			
<b>Më 1 janar</b>		<b>46,052,434</b>	<b>-</b>
Neto lëvizja e njësive për shkak të transfereve ndër portfolios		45,319,826	66,431,180
Njësitë e riblera për shkak të tërheqjeve të kursimeve		(29,749,043)	(20,378,746)
<b>Më 31 dhjetor</b>		<b>61,623,217</b>	<b>46,052,434</b>
Neto mjetet e njësuar të pjesëmarrësve	12	131,267,932	94,812,043
<b>Vlera e mjeteve neto për njësi në datën e raportimit</b>		<b>EUR 2.1302</b>	<b>EUR 2.0588</b>

Përgjatë vitit 2023 pjesëmarrës shtesë u kualifikuan për transferim në Portfolion Konservative. Gjatë periudhës 57,472,537 njësi u riblenë nga Portfolio Standarde dhe vlerat rezultuese janë shfrytëzuar për t'i blerë 45,319,826 njësi në Portfolion Konservative. Riblerja e njësive shtesë nga Portfolio Standarde dhe blerja e njësive në atë Konservative, u bënë me çmimet përkatëse për njësi të secilit portofol në datën e transferimit.

#### 15 PALËT E NDËRLIDHURA

Një palë është e ndërlidhur me një entitet nëse, drejtpërdrejt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me entitetin, pala ka një interes në entitet që i jep një ndikim domethënës mbi entitetin, pala ka kontroll të përbashkët mbi entitetin, pala është një bashkëpunëtor ose pala është një anëtar i personelit kryesor të menaxhmentit i entitetit ose shoqërisë mëmë të saj.

FKPKMP menaxhohet nga FKP KOP e cila ka kontroll të plotë mbi investimet e mjeteve pensionale. Transaksionet ndërmjet të dyjave kanë të bëjnë me (a) financimin e FKP KOP nga tarifat e ngarkuara mbi fondin siç përshkruhet në Shënimin 11, përshtatur për diferencën (pozitive ose negative) ndërmjet vlerës së njësive të tërhequra si pasojë e refondimeve dhe vlerës nominale të kontributeve të refonduara, siç përshkruhet në Shënimin 8; si dhe (b) suficitit të kthyer në FKP KMP nga FKP KOP, siç përshkruhet në Shënimin 10.

#### 16 NGJARJET PAS PERIUDHËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që do të kërkonin korrigjim ose shpallje të mëtejshme në pasqyrat financiare.